

PROPOZIMI NE KUVEND
NDRYSHIMI I TVSH, GATI
ULJA NGA 5 DERI NE 10%

► F4



RAMA NE ITALI:
FURNIZIM ME UJE NGA
SHQIPERIA PER PULIAN

► F10



[SHQIPTARJA.com]


ÇMIMI 30 LEKË

VITI V - NR. 219

E MËRKURË, 16-09-2015

www.shqiptarja.com

UNIVERSITETET



MATURANTET QEAPLIKONEME FORMULARIN A3

Regjistrohen edhe ata
që janë fitues ose nuk
kanë aplikuar më parë.
Ja kush përjashtohen
nga faza e fundit

► F12



DREJTORI I RTSH

**Peza: Ndryshojmë ligjin,
në raundin e 4 zgjidhet
me shumicë të thjeshtë**

► F13

LEGALIZIMET NDRYSHON PROCEDURA PER HIPOTEKIMIN

Rishikohen dokumentet nga pagesa e faturës deri në marrjen e tapisë. Lame: Do të ndahen 12 mln USD për ish-pronarët

► FAQE 2-3



HOMOSEKSUALET XHENI KARAJ: BISEDIME ME MINISTRINE PER BASHKEJETESEN

► F21



"SHENDETI" NDIKIMI I KRIPES DHE PESHES PER TENSIONIN E LARTE

Masat që duhen marrë dhe
ushqimet që këshillojnë mjekët

► F16-17



**Blue
Medical
Center**

Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara
sipas protokolleve të
njekësise bashkekohore
nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 668

Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al



PROCEDURAT
Drejtori i ALUIZNI-t, tha se do të thjeshtohen maksimalisht procedurat me Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për të bërë të mundur dhënien sa më të shpejtë të lejeve



2 MUAJ
Sipas procedurave aktuale, nevojiten minimalisht dy muaj që një dosje e miratuar nga ALUIZNI, të regjistrohet në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme



PAGESAT
Kreu i ALUIZNI-t bëri dje një bilanc të punës së institucionit, duke theksuar se arkëtimet nga pagesat e trojeve të legalizuara arrijnë për vitin 2015 në total 1.4 miliardë lekë (afërsisht 12 milionë Usd)




LEHTËSITË
Gjatë fjalës, Lame theksoi se në masë të madhe volumi i arkëtimeve i detyrohet lehtësirave të propozuara nga qeveria në shlyerjen e detyrimeve për legalizimin e trojeve

NISMA

Legalizimet, ndryshojnë procedurat e hipotekimit

Gati drafti i ri, përgjysmohet afati i regjistrimit në ZRPP



LORENC RABETA
TIRANE

Përmes disa ndryshimeve procedurale në trajtimin e dosjeve të ndërtimeve pa leje në hipoteka, pas një muaji do të përgjysmohet koha e dhënies së tapive për qytetarët. Në një dalje para medie, Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame, tha se do të thjeshtohen maksimalisht procedurat me Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për të bërë të mundur dhënien sa më të shpejtë të lejeve. Sipas procedurave aktuale, nevojiten minimalisht dy muaj që një dosje e miratuar nga ALUIZNI, të regjistrohet në zyrat e hipotekave. “Jemi duke riparë disa prej procedurave, kryesisht në raport me ZQRPP, për të thjeshtuar në maksimum këto procedura. Kemi pasur gatishmëri



Artan Lame

e ZRPP-së dhe jam i bindur që pas një muaji, do të jemi këtu për të shpallur këto masa të reja, të cilat intensifikojnë, minimalisht dyfishojnë shpejtësinë e operimit në procesin e legalizimit”, tha Lame në një konferencë për shtyp.

Burimet kanë bërë të ditur se, mes ZRPP dhe ALUIZNI-t kanë nisur konsultimet mbi dokumentet që do të thjeshtohen në regjistrimin e banesave të legalizuara. Për këtë mësohet se po shqyrtohen mundësitë për procesin

FONDI I KOMPENSIMIT, TREGUESIT

Për periudhën janar GUSHT 2015	janë arkëtuar 1,4 miliard lekë
Për periudhën janar MAJ-DHJETOR 2014	u arkëtuan 307 milion lekë
Për periudhën janar MAJ-DHJETOR 2014	u kompensuan 460 ish-pronarë
Për periudhën janar JANAR-GUSHT 2015	u kompensuan 460 ish-pronarë
Për periudhën, janë përfshirë në procesin e kompensimit 2290 ish-pronarë	
Plani vjetor sipas buxhetit të shtetit ka qenë 1 miliard lekë	

trojeve të legalizuara arrijnë për vitin 2015 në total 1.4 miliardë lekë (afërsisht 12 milionë dollarë), 4 miliardë lekë më shumë se ç'ishte planifikuar. “Sot, pas një viti e gjysmë të operimit të kësaj skeme, do të doja të publikoja disa shifra rreth realizimit të të ardhurave nga ky proces. Për periudhën maj – dhjetor 2014, u arkëtuan 307 milion lekë. Ndërsa për periudhën janar – gusht 2015, janë arkëtuar 1,4 miliard lekë” tha Lame. Gjatë fjalës, Lame theksoi se në masë të madhe volumi i arkëtimeve i detyrohet lehtësirave të propozuara nga qeveria në shlyerjen e detyrimeve për legalizimin e trojeve nga ata persona që kanë ndërtuar në tokë shtet, apo në toka me pronar. Ai theksoi se i vetmi detyrim që ju mbetet qytetarëve që kanë ndërtuar në truall jo të tyrin, pra shtet apo me pronar, është pikërisht pagesa e truallit.

e verifikimit të të dhënave, si dhe të koordinimit mes palëve përsa i përket hartës së vendosjes së banesave që legalizohet. Po ashtu dhe regjistrimi i faturave të paguara dhe procedura e kalimit të së drejtës së pronësisë do të

jen pjesë e marrëveshjes mes ALUIZNI-t dhe Hipotekës.

12 MILIONË DOLLARË

Kreu i ALUIZNI-t bëri dje një bilanc të punës së institucionit, duke theksuar se arkëtimet nga pagesat e

REGJISTRIMI NË HIPOTEKË, AFATI 30 DITË

Procedura në ZRPP 5 mijë lekë, kamatëvonesë 10 për qind

5 MIJË LEKË
Procedura e regjistrimit në Hipotekë kushton 5 mijë lekë, ndër kohë që, pas periudhës 30 ditore, qytetarët do të ngarkohen me një kamatëvonesë prej 10% për çdo ditë vonesë

Nga momenti i miratimit dhe dërgimit të dosjes së legalizimit në zyrat e regjistrimit të pasurive, qytetarët kanë 30 ditë kohë për të kryer hipotekimin e pronës dhe certifikatës së pronësisë. Procedura e regjistrimit në Hipotekë kushton 5 mijë lekë, ndër kohë që, pas periudhës 30 ditore, qytetarët do të ngarkohen me një kamatëvonesë prej 10% për çdo ditë vonesë. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka bërë publike në faqen e re zyrtare tarifën, afatet dhe kamatëvonesat e shërbimeve, ku bie në sy se nga momenti i marrjes së dosjes së miratuar nga ALUIZNI, procedura



e regjistrimit të pronës nuk mund t'i kalojë dhjetë ditët.

KAMATËVONESAT

Zyra qendrore e regjistrimit të pasurive ka krijuar faqen e re zyrtare ku ka bërë publike çmimet e shërbimeve, afatet, bashkë me penalitetet që do t'u ngarkohen subjekteve që nuk respektojnë termat kohore. Sipas tabelave, subjektet do të ngarkohen me kamatëvonesë nëse shkelin afatet ligjore për disa nga veprimet për të cilat ligji përcakton afate kohore. Kështu, nëse regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ, nuk

kryhet brenda afatit kohor prej 30 ditësh, subjekti do të ngarkohet me një kamatëvonesë prej 10% të shumës 3,500 lekësh që është tarifa e këtij shërbimi. Kamatëvonesë do të paguhet gjithashtu edhe në rastet kur nuk kryhet në kohë regjistrimi i aktit për kalimin e pronësisë nga përmbartuesi gjyqësor, regjistrimi i kontratave të shitjes, regjistrimi i kontratës së dhurimit, regjistrimi i titujve “në përdorim”, apo regjistrimi i aktit të trashëgimisë. Kamatëvonesë prej 10% në ditë parashikohen gjithashtu edhe për objektet e legalizuara të cilat nuk regjistrohen brenda 30 ditëve, siç parashikon ligji.



ALUIZNI/ AGJENCIA EVIDENTON NË TERREN SIPËRFAQET

Tiranë, ALUIZNI zbardh 55 zonat me ndërtime informale

Pas evidentimeve në terren, ALUIZNI ka zbardhur 200 zonat informale të përfshira zyrtarisht në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, 55 prej të cilave në Tiranë. Të tëra zonat të marra së bashku zënë një sipërfaqe totale prej 7,411 hektarësh. Zbardhja e këtyre zonave u bë pas një vendimi të qeverisë që mban datën 10 shtator 2014 ku përcaktohetin procedurat "të evidentimit faktik në terren të ndërtimeve pa leje, shtesave në ndërtime me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale".

ZONAT INFORMALE

Në përcaktimin e Qeverisë, Zonë informale do të konsiderohet territori me

sipërfaqe mbi 2 hektarë, i zënë nga ndërtime informale, procesi i legalizimit të të cilave nuk u nënshtrohet kushteve të instrumenteve të planifikimit të territorit. "Drejtoritë në varësi të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), për propozimin e zonës informale, orientohen nga: evidentimi faktik i ndërtimeve informale në territorin përkatës; vija kufizuese administrative e njësisë të qeverisjes vendore; morfologjia dhe kushtet e relievit; gjendja e pronësisë dhe cilësitë juridike të territorit" përcakton Qeveria. Sipas ligjit të ri të legalizimit ndaj ndërtimeve që gjenden brenda zonave informale aplikohen procedura më të lehta.

Lame: Ja si do shpërndahen paratë për pronarët e tokës

Afati i vetëdeklarimeve, fundi i muajit shtator. I gjithë fondi prej 12 milionë dollarësh do të shkojë për kompensimin e pronarëve

LORENC RABETA
TIRANE

E gjithë shumta prej 12 milionë dollarësh, e akumuluar nga pagesat për legalizimin e trojeve të objekteve pa leje, do të përdoret për kompensimin e pronarëve të këtyre sipërfaqeve. Sipas kreut të ALUIZNI-t Artan Lame, për këtë qëllim, do të përdoren jo vetëm shumat e arkëtuara nga legalizimi i tokave me pronar, por edhe sipërfaqeve në pronësi të shtetit. "Në zbatim të Ligjit 10239 të vitit 2010 "Për krijimin e Fondit Special të kompensimit të pronave", e gjithë shumta e arkëtimeve, ka destinacionin pagesën e pronarëve të shpronësuar nga procesi i legalizimit. Në këtë proces, edhe paratë që grumbullohen nga truallit shtet, shkojnë për të plotësuar shpërblimin e ish-pronarëve", tha dje Lame gjatë një konference për shtyp.

KËRKESAT E PRONARËVE

Lame theksoi se një nga motivet e përshpejtimit të procesit të legalizimeve, ka të bëjë pikërisht me kërkesat për kompensim të ngritura prej pronarëve të prekur nga ndërtimet pa leje. "Në drejtoritë tona rajonale, si edhe në drejtorinë e përgjithshme, janë depozituar një numër i madh kërkesash të ish-pronarëve që ju është zënë truallit me ndërtime pa leje dhe që kërkojnë përshpejtimin e procesit të legalizimit, pikërisht me qëllimin që ata të përfitojnë kompen-

Afati

Në zbatim të Ligjit 10239 të vitit 2010 "Për krijimin e Fondit Special të kompensimit të pronave", e gjithë shumta e arkëtimeve, ka destinacionin pagesën e pronarëve të shpronësuar nga procesi i legalizimit. Edhe paratë nga truallit shtet, shkojnë ish-pronarët



simin financiar për truallin e zënë", tha Lame. Duke u folur për kategorinë e pronarëve, lame theksoi se kjo shtesë qytetarësh prej vitësh mbahej peng nga pamundësia për t'u kompensuar për sipërfaqet e zëna. "Edhe nga kjo pikëpamje duhet thënë se pro-

cesi i legalizimeve ka krijuar besim edhe tek kjo shtesë qytetarësh, e cila prej vitësh ishte zënë në kurthin pa dalje që truallin as e gëzonte dot se ju ishte zënë, e as mund të kompensohej sepse procesi i legalizimeve kishte ngecur", tha Lame.

AFATI I VETËDEKLARIMEVE

Lame theksoi se afati i fundit i vetëdeklarimeve është fundi i shtatorit, duke shtuar se një vendim i tillë u mor për t'u dhënë mundësinë emigrantëve të kryerim aplikimit. "Ju kujtoj se fushata kishte të bënte kryesisht me vullnetin

297,440 OBJEKTE

ALUIZNI: 29.5% e ndërtimeve në Shqipëri janë pa leje

Sipas të dhënave zyrtare të ALUIZNI-t, 29.5% e ndërtimeve në territorin shqiptar janë pa leje. Ndërsa në total numri i ndërtimeve në Shqipëri është 1,008,243, në bazën e të dhënave të Agjencisë së Legalizimeve 297,440 prej tyre rezultojnë objekte informale. Ndërkohë që është Qarku i Durrësit ai që përmban edhe numrin më të madh të ndërtimeve pa leje: objektet informale përbëjnë plot 49.49% të totalit të ndërtimeve në gjithë territorin e Qarkut. Qark tjetër me përqendrim masiv ndërtimesh pa leje është ai i Tiranës, ku objektet informale përbëjnë thuhet 36% të totalit duke arritur në total shifrën 94,264. Rrethe ku ndërtimet informale zënë përqindje të konsiderueshme në raport me totalin janë edhe Shkodra ku 33.38% e objekteve janë pa leje, Lezha me 34.24%, Fieri me 29.94%, Elbasani me 28.48%, apo Vlora me 28.04%. ALUIZNI ka zbardhur të plotat të dhënat e ndërtimeve me leje dhe pa leje në rang territorit. Në tabelat zyrtare janë pasqyruar edhe të dhënat mbi numrin e vetëdeklarimeve të bëra nga qytetarët, si dhe lejet e legalizimeve të miratuara që nga viti 2006, deri në vitin 2014.

për t'i krijuar mundësinë emigrantëve, të cilët arrijnë të vijnë në Shqipëri vetëm gjatë muajve të pushimeve, në qershor, korrik, gusht. Për ta, kjo periudhë është e vetmja mundësi për të kryer vetëdeklarimet apo për të ndjekur procedurat e legaliz-

imeve. Për shkak të tyre, gjatë periudhës së pushimeve, drejtoritë tona u detyruan të mbanin sportelet hapur. Shumica e tyre arritën të përfitojnë nga kjo hapësirë dhe besoj që edhe ata që kanë mbetur, do arrijnë t'i përfundojnë vetëdeklarimet brenda shtatorit", tha Lame.

Ruli

Ne kemi avion turistikë që bredhin mbi Shqipëri që përveç njerëzve mbajnë disa thasë me drogë dhe kjo është pjesë e saj

**TVSH**

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese Ministri tha se TVSH në Turizëm mund të ulet deri në 8% apo 5%, në varësi të konsultimeve me institucionet përkatëse

DEKRETI

Ministri mbrojti draftin duke përkufizuar si të paqëndrueshme argumentet e Presidentit. Deputetët rrëzuan dekretin e Presidentit duke lënë në fuqi draftin e propozuar nga Qeveria

**Bushati**

Dhatë një shifër prej 900 e ca investitorë të huaj. Dilni publikisht dhe thoni emrat e 10 kompanive të huaja që kanë ardhur pas 2013

LORENC RABETA
TIRANE

Debate në Kuvend, Ministri: Ulim TVSH-në në turizëm

Nis diskutimi, Ahmetaj: Ndoshta TVSH ulet deri në 10%, ndoshta 8%, ndoshta dhe 5%

Ministri Arben Ahmetaj ka bërë dje me dije se Qeveria po merr në konsideratë mundësinë e uljes së TVSH-në sektorin e Turizmit. Gjatë diskutimeve në Komisionin Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit mund të ulet deri në 8% apo 5%, në varësi të konsultimeve me institucionet përkatëse. "Qeveria ka marrë vendim akoma jo në rrugë aktesh që të bëjë ndryshimet në ulje të TVSH-së ndoshta 10%, ndoshta 8%, ndoshta dhe 5%. Është duke u bërë një analizë dhe një debat brenda strukturave fiskale dhe pastaj kuptohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do bëj propozimin", tha Ahmetaj. TVSH në sektorin e Turizmit, në vlerën e 20 për qind e cilësuar si mjaft e lartë krahasuar me vendet fqinje por edhe me të tjera të Evropës do të ulet.

DEKRETI

Deklaratat u bënë nga Ahmetaj gjatë diskutimeve të dekretit të Presidentit të Republikës, i cili kishte kthyer për rishqyrtim projektligjin për Turizmin. Ministri i Ekonomisë mbrojti draftin duke përkufizuar si të paqëndrueshme argumentet e Presidentit. Deputetët në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese rrëzuan dekretin e Presidentit duke lënë në fuqi draftin e propozuar nga Qeveria. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, duke iu referuar argumentimit të Presidentit se ky projekt ligj bie në kundërshtim me prokurimet publike, tha se nga ky proces përjashtohen vetëm projektet për promovimin e Shqipërisë jashtë vendit. "Kemi dashur

me kohë por nuk arrijmë dot sepse na ka penguar ligji prokurimit, të bëjë promovimin e Shqipërisë në disa televizione në Çeki, Poloni, Suedi, e kemi të pamundur, nuk gjejmë dot

një instrument ligjor të saktë. Zonat me përparësi turizmi vendosin administrim të centralizuar për sa i përket zhvillimit të turizmit dhe nuk cenon asnjë të drejtë të pushtetit

vendor", tha ministri.

DEBATET

Duke ironizuar me atë që ofron sot turizmi shqiptar, deputeti demokrat



Genc Ruli tha se sot kemi 8 mijë turistë që i kemi çuar në kampe refugjatësh në Gjermani, është një imazh shumë i mirë, jemi fill mbas Sirisë që ka luftë civile. "Ne kemi avion turistikë që bredhin mbi Shqipëri që përveç njerëzve mbajnë disa thasë me drogë dhe kjo është pjesë e saj. Ne kemi njerëz që punojnë, i janë qepur maleve dhe kodrave dhe beshkët më shumë seç kanë pisha dhe ar por kanë një lule marramendëse që i nxit turistët që është kanabisi. Nuk e kuptoj pse nuk ka ndryshuar ligji prokurimit për atje të thuhet ky ka përjashtim përveç përmenden 2-3 sektorë të tjerë edhe për turizmin për këto lloje projektesh. Pse futet ky në ligjin e turizmit?! Kur ke një projekt konkret atëherë po mund të bësh një inventar të përcaktosh në atë zonë sa ke tokë publike, sa nga kjo është e pushtetit vendor sa është e pushtetit qendror dhe sa është tokë private. Preket ai që është ligji kuadër për shpronësimin", u shpreh deputeti demokrat Genc Ruli.

INVESTITORËT

Ndërkohë që deputeti tjetër i djathtë, Elidon Bushati i kërkoi ministrit Ahmetaj të bëjë publike 10 emra investitorësh në Shqipëri që kanë hyrë në vitin 2013, referuar deklaratave të mëparshme të qeverisë për rritjen numrit të investitorëve të huaj që shkon në 900. "Të dhënat zyrtare tregojnë që ka një rënie në 2013 prej 124 milion eurosh. Dhatë një shifër prej 900 e ca investitorë të huaj që kanë hyrë në Shqipëri pas vitit 2013, dilni publikisht dhe thoni emrat e 10 kompanive të huaja që kanë ardhur pas vitit 2013 për të investuar në Shqipëri", tha Tahiraj. "Unë do të jap 20 emra publikisht, të ftoj të vish me mua të Foshner nesër dhe të shohësh një investim real gjerman një nga ata 20 që do të të jap", u shpreh ministri Ahmetaj.

KONCESIONI/ HAPJA E OFERTAVE SHTYHET NË DATË 15 TETOR

Tenderi i Rrugës së Kombit, ja 4 kompanitë

Do të përcaktohet edhe tarifa e saktë për të kaluar në aksin Milot Morinë

Hapja e ofertave të kompanive që kanë aplikuar për marrjen me koncesion të rrugës së Kombit është shtyrë për në datë 15 Tetor. Vlerësimi i ofertave do të bëhet në këtë datë, ku do të përcaktohet edhe tarifa e saktë për të kaluar në aksin Milot Morinë, megjithëse deri më tani është thënë se do të jetë 5 euro. Ndërkohë që dje janë zbardhur emrat e katër kompanive që janë në garë, nga të cilat sipas Ministrisë së Transporteve, do të përzgjidhet oferta më e mirë. Kështu kompanitë që kanë dorëzuar ofertën janë "China Communications Construction Company"; Grupi "Vendeka Bilgi Teknolojileri Ltd.Sti. PT Citra Marga Nusaphala Persada TBK Salillari Ltd Savronik Sistem.Tah. San.



Tic. A.S.Mr; Aktor Concessions S.A Egis Projects S.A; dhe GEK Tema/Terna.

Duke lidhur Milotin, rreth 60 km në veri lindje të Portit të Durrësit në detin Adriatik, me Morinën në kufirin e Kosovës, rruga formon seksionin qendror të autostradës Kosovë-Shqipëri, që lidh Durrësin me Prishtinën, dhe në të kalojnë një numër i lartë automjetesh, çka do të thotë se çdo kompani ka interes për të fituar tenderin. Objektivi kryesor i këtij koncesioni është përmirësimi i autostradës, funksionimi dhe mirëmbajtja efektive e saj. Koncesioni do të zgjasë për një periudhë 30 vjeçare dhe kompania fituese do të mblodhë dhe të mbajë të ardhurat nga taksat dhe në

këmbim do të ketë përgjegjësinë për të zbatuar dhe financuar përmirësimet e autostradës, të ndërtojë një urë të re mbi lumin Drin në Kukës dhe të zbatojë punimet më urgjente gjeoteknike të stabilizimit. Dhënia me koncesion e rrugës së Kombit është lajmëruar dy vjet më parë, por duket se tashmë nuk ka më kthim mbropa. Nga ana tjetër, pas këtij segmenti, taksimi do të vendoset në të gjitha rrugët kryesore të Shqipërisë, pasi BERZH ka dhënë një grant prej 149 mijë eurosh dhe ka përzgjedhur kompaninë "Egnatia Odos" e cila ka kohë 8 muajt të bëjë strategjinë dhe të dalë me një hartë për studimin e rrugëve sa ka kushtuar secila dhe sa mund të vendoset taksat.

Zbardhen SMS e familjes Cali me Tahirin dhe kryeministrin

Gjergj Cali: Jemi dakort me tenderin, por ka ndërhyrje



NË FOTO:
Ministri Tahiri (djathtas)
Gjergj Cali (majtas)
Armando Prenga



SMS-të

- 1 → "Zoti Saimir Tahiri, deputeti Armando Prenga më ka gjuajtur me pistolet dhe jam I gjakosur, policia nuk vjen fare në vendngjarje. Ju lutem merrni masa".
- 2 → "Do marr masa patjetër. Është angazhuar e gjithë policia"
- 3 → "I nderuar zoti ministër na fal për shqetësimin, por duket e pa drejtë që policia e shtetit ndlon fshatarët e mi për të ndërruar 2 tregulla të shtëpisë dhe deputeti i zonës së Lacit vazhdon ndërtimin në mes të Lagunës së Patokut dhe për çudi policia nuk merr asnjë masë por e mbështet në punimet që bëjnë. Aq më tepër që në vendin ku po ndërtojnë janë sjellë edhe 400 pisha të sapo prera. Me respekt kryetari i fshatit Patok".
- 4 → "Policia merr në procedim të gjithë qytetarët, pa dallim, që ndërtojnë pa leje. Në këtë rast, i dërgova policisë shqetësimin tënd për të bërë të gjitha verifikimet".
- 5 → "I nderuar zoti kryeminister, na falni për shqetësimin që ju krijojmë për her të dyt, po jetojmë momente shumë të vështira psikologjike. Pas 75 vitesh pun pa shkëputje në lagunën e Patokut. Sipas ligjeve shqiptare jemi në tenderim dhe jemi dakort me tenderimin, por nuk jemi dakort që subjekti që konkuron përfaqësohet nga familja Armando Prenga, sepse dyshohet për ne se ka ndërhyrje në ministri për të marrë këtë tender".

LAJME shkurt



Arrestohet pronari i autobotit, shiste ujë pa kupon tatimor

Pronari i subjektit ujë "KOND" shpk është arrestuar nga policia e Fierit pasi gjatë kontrollit ka rezultuar se ai tregtonte ujë pa kupon tatimor dhe të pa pajisur me fletë-analizat e detrueshme. Bëhet e ditur se në pranga ka rënë 51-vjeçari Ferdinand Konda, i cili do të përballet me akuzën e fshehtësisë së të ardhurave dhe falsifikimit të dokumentacionit. Policia gjithashtu ka sekuestruar edhe dy autobotë me ujë të 51-vjeçarit në cilësinë e provës materiale.

E dhunonte bashkëjetuesi, tenton të vrasë veten

Një 21-vjeçar nga Berati ka tentuar vetëvrasjen nën presionin e dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj saj. E reja ka qëlluar veten me thikën e kuzhinës në bark si pasojë e dhunës së ushtruar nga bashkëjetuesi i saj 35-vjeçar me inicialet I.Ç. Ky i fundit u arrestua bë flagrancë nga policia, ndërsa me bluzat e bardha mësohet se 21-vjeçarja është jashtë rrezikut për jetën. 35-vjeçari akuzohet për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Shkaktimi i vetëvrasjes".



Mat, gjenden 1.200 rrënjë kanabis, asnjë i arrestuar

Aksioni antiknabis i policisë ka vijuar gjatë ditës së djeshme edhe në rrethin e Matit. Nga kontrollat e ushtruara në terren, uniformat blu të Matit kanë gjetur dhe asgjësuar 1.200 rrënjë kanabis sativa. Mësohet se bima narkotike ishte mbjellë në 4 parcela në vendin e quajtur "Përroi i Kukës". Policia asgjësoi bimët narkotike nëpërmjet djegies, ndërsa njofton se po punon për identifikimin dhe kapjen e kultivuesve.

ELTON QYNO TIRANE

Kyrrja e telefonave të anëtarëve të familjes Cali, ka zbuluar disa mesazhe të cilët i kanë dërguar ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri dhe kryeministrin Edi Rama. Këtyj të fundit, i ka shkruar Gjergj Cali, ka tregon se ndihet në presion psikologjik, pasi lagunën ku ata kanë punuar prej 75 vitesh me rradhë, do jua marrë nëpërmjet një tenderi familja e deputetit të PS Armando Prenga. Në sms-në, që tashmë është administruar në dosjen e Prokurorisë së Përgjithshme familja Cali ankohet tek kryeministri Rama se tenderi po manipulohet nga familja Prenga, e cila përfaqësohet nga deputeti i PS Armando Prenga. Veç këtij mesazhi, grupi hetimor ka sekuestruar dhe disa sms të tjera ku evidentohet dhuna e ushtruar nga deputeti Armando Prenga, tek shtetasi Gjok Cali. Këto mesazhe i janë drejtuar ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri. Mesazhi është dërguar në 4 shtator, vetëm pak minuta pasi është goditur me armë nga deputeti Armando Prenga.

KËRKESA PËR NDIHMË

SMS mban orën 23:46 shtetasi Gjok Cali i shkruan ministrin, duke njoftuar për ngjarjen dhe kërkon ndihmë, pasi siç thotë ai policia e Laçit nuk shkon në vendin e ngjarjes. "Zoti Saimir Tahiri, deputeti Armando Prenga më ka gjuajtur me pistolet dhe jam i gjakosur, policia nuk vjen fare në vendngjarje. Ju lutem merrni masa". Ky mesazh, rezultoi se është nisur nga shtëpia e Gjok Cali që ndodhet në Push-Kuqe, vetëm pak minuta pas përplasjes me deputetin Prenga në rrugën Patok-Laç. Më pas, referuar materialeve të prokurorisë, Gjok Cali i shoqëruar nga policia dhe pjesëtar të familjes së tij është nisur drejt Komisarariatit të Laçit për të bërë denoncimin. Dhe pikërisht këtu, pjesëtarët të familjes Cali janë përplasur fizikisht dhe me armë me të afërmit

Mesazhi denoncues "Po arrestoni për dy tregulla Prenga ka lokal pa leje"

Përpara se të niste përplasja mes deputetit Prenga dhe anëtarëve të familjes Cali, Gjok Cali në cilësinë e kryeplakut të fshatit Patok, i ka dërguar një sms, ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri, duke e vënë në dijeni se familja e deputetit Armando Prengës, është duke ndërtuar një lokal pa leje dhe askush nga institucionet nuk e ka verifikuar. Në tekstin e sms thuhet: "I... nderuar zoti ministër na fal për shqetësimin, por na duket e pa drejtë që policia e shtetit ndalon fshatarët e mi për të ndërruar dy tregulla të shtëpisë dhe deputeti i zonës së Lacit vazhdon ndërtimin në mes të Lagunës së Patokut dhe për çudi policia nuk merr asnjë masë, por e mbështet në punimet që bëjnë. Aq më tepër që në vendin ku po ndërtojnë janë sjellë edhe 400 pisha të sapo prera. Me respekt kryetari i fshatit Patok...". Ky mesazh ka shkruar në adresë të ministrin Tahiri i cili ia ka kthyer përgjigje "...policia merr në procedim të gjithë qytetarët, pa dallim, që ndërtojnë pa leje. Në këtë rast, i dërgova policisë shqetësimin tënd për të bërë të gjitha verifikimet...". Kjo korrespondencë është bërë në datën 19 gusht të 2015. Dy javë pas këtij mesazhi, në 5 shtator dy familjet Cali dhe Prenga janë përplasur fizikisht me njëra-tjetrën ku shak i kasaj situatë është bërë kapja e monopolit të peshkimit në lagunën e Patokut që ndodhet në Laç. Pas kësaj përplasje është arrestuar Armando Prenga i cili është lënë në "arrest në burg" nga Gjykata e Laçit.



Lokali i familjes Cali te laguna e Patokut

dhe deputetin Prenga, ku për pasojë mbetën të plagosur 7 persona, dy prej tyre me armë zjarri.

TAHIRI KTHEN PËRGJIGJE

Teksa kanë shkruar në ambientet e komisarariatit dhe janë përplasur fizikisht me anëtarët e familjes Prenga, të plagosurit më pas janë transportuar në

spitalin e Laçit, ku kanë marrë ndihmën e parë mjekësore. Pikërisht në këtë kohë ministri i Brendshëm Tahiri ka kthyer një përgjigje tek Cali, duk i pohuar se: "Do marr masa patjetër. Është angazhuar e gjithë policia". Ky mesazh mësohet të jetë dërguar nga Tahiri në orën 01:33 minuta dhe në atë kohë rezultoi se përplasja mes dy familjeve

kishte mbaruar dhe të plagosurit ishin nisur drejt spitalit në Tiranë, ku edhe u shoqërua nga policia deputeti Prenga. Veç këtyre sms, pritet që në ditët në vijim anëtarët e Grupit Hetimor në Prokurorinë e Përgjithshme të njihen dhe me tabulatet telefonike që ka pasur deputeti Prenga, para dhe pas konfliktit me anëtarët e familjes Cali.

Prova dhe fakte ka premtuar të japë kryeministri Edi Rama përballë lumit të akuzave të opozitës se qeveria është e lidhur me trafikun e drogës, e veçanërisht ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri të cilit demokratët i kërkojnë të dorëhiqet. Përmes një njoftimi në profilet e tij zyrtare në rrjetet sociale, kreu i qeverisë shqiptare thotë se të mërkurën (sot) në orën 11:00 do të flasë live në televizionet shqiptare për këto akuzat. "Të gjithë do të mund të shohin se kush e ka lejuar dhe kush e ka luftuar drogën në Shqipëri", - shkruan kryeministri Edi Rama. Burime konfidenciale për Shqiptarja.com thanë se provat e paralajmëruara nga Rama pritet të publikohen në një konferencë të drejtpërdrejtë në Pallatin e Kongreseve që kryeministri do të mbajë me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Haki Çako, ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri e ku pjesëmarrës do të jenë dhe ambasadorët të akredituar në vendin tonë. "Faktet të cilat kryeministri i sheh si provë të fortë kundër opozitës, - thanë burimet, - pritet të paraqiten në formën e rezultateve të një raporti

Faktet

"Faktet të cilat kryeministri i sheh si provë të fortë kundër opozitës, - thanë burimet, - pritet të paraqiten në formën e rezultateve të një raporti me të dhëna për trafikun e drogës."



Provat

"Provat e reja pritet të implikojnë ish-drejtnes pranë Ministrisë së Brendshme dhe përfaqësues të opozitës aktuale, pse është lejuar dhe nga kush është lejuar trafiku i lëndëve narkotike"

Rama: Sot prova se kush e lejoji trafikun e drogës

Konferenca sot në mesditë në Pallatin e Kongreseve me Tahirin, Çakon dhe ambasadorët

me të dhëna për trafikun e drogës - pse është lejuar dhe nga kush është lejuar trafiku i lëndëve narkotike". Të njëjtat burime, sqaruan se provat e reja pritet të implikojnë ish-drejtnes pranë Ministrisë së Brendshme dhe për-

faqësues të opozitës aktuale. Reagimi i fortë paralajmëruar i kryeministrit Edi Rama vjen pas akuzave thajuese të përditshme të opozitës, e cila përmes deklaratave nga deputetë të ndryshëm nga selia blu e akuzon qeverinë

se jo vetëm është duke lejuar trafikun e drogës, por është edhe vetë e përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Më i "shigjetuari" nga sulmi i PD-së ka qenë ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri. Për demokratët intervista e

ish-shefit të Antidrogës në arrati për dekonspirim të operacioneve të policisë, u kthye në "provën" e tyre më të fortë se Tahiri është i lidhur me trafikun e drogës dhe për këtë arsye duhet të dorëhiqet. Ndërkohë fakt

është se gjatë qeverisjes Berisha u asgjësuan 7.5 për qind e lëndës narkotike, ndërsa në vitin 2015 janë asgjësuar 96 për qind. Gjë që duket se flet për një tolerim të kultivimit të kanabisit. Vetë ministri Tahiri i dha përgjigje këtyre akuzave nga sala e Kuvendit në këtë sesion të ri parlamentar, duke thënë ndër të tjera se historia e treguar nga Dritan Zagani dhe që e përfshin atë në trafik, është e sajuar me qëllimin që ish-oficeri të mund të përfitojë azilin politik. Ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri, ka reaguar për herë të parë në lidhje me akuzat e njëpasnjëshme që kanë ardhur nga opozita, veçanërisht për lidhje të tij me trafikun e drogës. Ministri ka bërë një reagim të gjatë në rrjetin social Facebook, ku shprehet se qeveria është e vendosur për të kryer reformën në drejtësi, dhe luftën kundër krimit të organizuar, duke lënë të kuptohet se nuk ka në plan të japë dorëheqjen si ministër pas kërkesës së PD-së. Shefi i Punëve të Brendshme shprehet i rrethuar për faktin që ish-shefi i Antidrogës Dritan Zagani, i shpallur në kërkim për dekonspirim të operacioneve anti-drogë, po shfrytëzohet nga opozita.

LAJME SHKURT



PD, Hajdarmata: Krahu i djathtë i Tahirit është pezulluar dy herë

Opozita është e vendosur në kërkesën e saj për dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme Saimir Tahiri. Deputetja demokrate, Mimoza Hajdarmata deklaroi dje se inspektori personal i Tahirit është dy herë i përjashtuar nga Policia e Shtetit për shkelje. Bëhet fjalë për Anastas Meçi, për të cilin deputetja demokrate paraqiti edhe shkresat zyrtare për dy rastet e pezullimit të tij. "Pikërisht, me të tillë persona, Ministri Tahiri mbyll aferat e tij dhe kujdeset për bizneset e tij kriminale. Ai është sot ministri më i akuzuar në dy dekadat e fundit, për lidhje me bandat e trafikut të drogës", tha Hajdarmata.

MPB i përgjigjet PD-së: Meçi s'është në varësinë e Tahirit


Ministria e Brendshme ka reaguar ndaj akuzave të Partisë Demokratike. Peërmes një njoftimi, MPB sqaroi se Anastas Meçi, për të cilën PD-ja akuzoi se është përjashtuar dy herë nga radhët e policisë, nuk punon në Policinë e Shtetit por në administratën publike që nuk është në varësi të Ministrit të Brendshëm. "Saktësojmë se në vitin 1996, z. Meçi është liruar nga detyra në Policinë e Shtetit, jo përjashtuar sic deklaroi PD-ja, ndërkohë sa i përket urdhërit të vitit 2001, z. Meçi është përjashtuar pa respektuar procedurën", sqaroi Ministria e Brendshme.



PD, Noka: Rama e Tahiri fshehën dosjen e Frrokut

Rikthimi në detyrë i kreu të Interpol Tirana, Artan Bajraktari, i cili me vendim gjykatë pasi ishte pushuar me argumentin se nuk kishte raportuar për dosjen belge të deputetit Mark Frroku, është bërë shkas për opozitën që t'ia atribuon fajet e shprehjes së dosjes kryeministrit Rama dhe ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri. "Ish-drejtori i Përgjithshëm i Policisë Artan Didi, që të mbyllte gojën, u dërgua me ngritje në Amerikë nga Edi Rama. Akti i rëndë i fshehjes së kërkesës së interpolit, ky bashkëpunim i hapur me krimin, tashme ka ngelur në derën e Saimir Tahirit dhe Edi Ramës", tha deputeti i PD-së, Flamur Noka.





EUROPEAN UNION

The European Union Delegation to Albania is looking for International Relations Officer

We are

The European Union (EU) is an economic and political partnership between 28 European countries. It plays an important role in international affairs through diplomacy, trade, development aid and working with global organisations. Abroad, the EU is represented through more than 140 diplomatic representations, known also as EU Delegations, which have a similar function to those of an embassy.

The EU Delegation to Albania is a permanent diplomatic mission. The Delegation's main tasks are the following:

- ◆ Facilitate the development of political and economic relations between the EU and Albania in the framework of the Stabilization and Association Process (SAP), which is the strategy for helping Albania in its path towards integration into the EU.
- ◆ Managing EU Assistance programmes.
- ◆ Disseminating information on the EU, informing the Albanian general public, decision makers and opinion formers about the integration process, EU institutions and its policies.

We offer

We offer a post of International Relations Officer - Parliament and other Institutions in Political, Economic and Information Section to carry out under the supervision of the Head of Political, Economic and Information Section advisory and reporting duties, as well as ensure effective and efficient implementation of financial assistance in the area of Parliament and other institutions. Ensure maximum impact to support the EU membership preparation of the beneficiary country. Ensure fulfillment of sector/chapter reporting obligations based on communicated cross-sections responsibilities. The selected person will closely follow up and analyse political developments in Albania, in particular, in relation to the Albanian Parliament, support policy dialogue with the Parliament, agencies, donors and other relevant stakeholders in the area of concern, draft comprehensive weekly and ad-hoc reports, flash reports, notes for the file, briefings, input to speeches as well as contributions to the bi-monthly SAA reports and the annual Progress Report; contribute to sector analysis and to the programming of activities under the Instrument for Pre-accession Assistance (IPA); contribute to the programming, identification and appraisal in close cooperation with the beneficiary institutions in the country; if and when such programmes are decided in the programming process; initiate and process all aspects of the procurement process drafting Terms of Reference, launching tenders, evaluating the bids, preparing the contracting file; Encode contracts and give an "operational visa" (GESTOPE) on documents where required; Monitoring ongoing projects, attend management and monitoring meeting, elaborate progress report on projects and propose action if and when needed; Provide "Certified correct" for payments; Maintain contacts with other donors active in the country; Monitor and report on sectoral issues to Team Leader/ Head of Section (including Early Warning on potential disputes); Timely reporting related to sector reports, weekly, bi-monthly, Annual reports, EC's Progress report and ad-hoc reports related to the sectors covered as well as input for sub-committees, IPA MC, SAA, etc.; Maintain regular contacts with political, media and relevant public institutions and other relevant stakeholders; Produce and disseminate the results of projects at workshops, seminars, conferences and other public events contributing to the achievement of the Delegation's objectives for the visibility of EC activities in the country; Extract and disseminate "best practice" and facilitate exchange of experiences; Input for occasionally drafting of briefings and speeches; Contribute to the organisation, participate in and follow up to regular and ad hoc missions from Headquarters to Albania.

Place of employment will be Tirana, Albania. The length of the working week shall be 37h30. The post is of Group I with a starting basic salary of 240996 ALL per month.

We offer a competitive progressive career in an international environment. Benefits, such as additional medical insurance, are offered to employees and their families under certain conditions.

We look for

- ◆ Relevant University degree preferably in Law or Political Science
- ◆ English (spoken and written) - high level (C1)
- ◆ Job related experience: at least 5 years of experience; Previous experience of working in an international organizations or diplomatic mission would be an advantage
- ◆ Knowledge on Budget, Finance and Contracts

How to apply

Please send your application and supporting documents to:

Mrs Annamaria Bottini
Head of Administration
Delegation of the European Union to Albania
ABA Business Centre, 17th floor, Rr. Papa Gjon Pall II,
Tirana, Albania
Fax: +355 4 227 4410

The application should include a cover letter, a detailed CV, and relevant supporting documents and should arrive not later than **30 September 2015**. Short-listed candidates will be contacted by the Delegation before **7 October 2015**.

The Delegation will not supply additional information or discuss the selection procedure by telephone; please address any queries concerning this procedure to Delegation-Albania@eeas.europa.eu

Rrëzohen dekretet e Nishanit për Arsimin e Turizmin

Debate brenda mazhorancës, Kosta: Po bën gallatë, Ahmetaj: Problemin e keni ju

LEONARD QUKU
TIRANE

Mazhoranca rrëzoi dje në komisionet parlamentare, dy dekretet e Presidentit Bujar Nishani, atë për "Arsimin e Lartë" dhe "Turizmin". Ishte komisioni parlamentar i Medias dhe Mjeteve të Edukimit që hodhi poshtë kthimin e ligjit nga Nishani, ndërsa nga ana tjetër demokratët paralajmëruan ankimm në Gjykatën Kushtetuese. Në një kohë kur komisioni i Medias rrëzonte dekretin e kthimit të pr/ligjin e "Arsimit të Lartë", paralelisht edhe komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, rrëzoi me votat e mazhorancës një tjetër dekret të Presidentit, ligjin për "Turizmin". Mbledhja e komisionit u shoqërua edhe nga një debat brenda mazhorancës, atë mes ministrit Arben Ahmetaj dhe deputetit të PS, Vladimir Kosta, çka bëri që ky i fundit të braktisë mbledhjen. Pas rrëzimit në komisionet parlamentare, mazhoranca ka paralajmëruar se të dy dekretet do rrëzohen edhe në seancën e Kuvendit, gjatë

DEBATET

Arben Ahmetaj: Unë e kam për kënaqësi ta frymëzoj zotin Bushati të djathtë. Në fakt mendohej që në parlament ta frymëzojmë njëritjetrin në vazhdimësi dhe funksionon edhe në karikimin politik. Unë vetë jam i dhënë pas turizmit malor, nuk para dal në diell. Kështu që thëni kjo ushtrij edhe presionin tim personal aq sa mundem që të fokusohem tek turizmi malor. Kështu që mua me ke aleat nuk më ke kundërshtar në aspektin e zhvillimit të turizmit malor.

Vladimir Kosta: Po bën gallatë...Kjo është mungesë serioziteti.

Arben Ahmetaj: Nëse e quan gallatë ligjin e Turizmit...

Vladimir Kosta: Unë s'merrem me gallata, kështu që po iki. Ti po bën shou politik këtu.

Arben Ahmetaj: Problemin e keni tek vetja, unë ja tek i kam kolegët, të gjithë deputetët janë këtu.

ditës së enjte.

PËRPLASJA

Ministri i Ekonomisë, Arben Ahmetaj, dhe deputeti i Qarkut të Gjirokastrës, Vladimir Kosta, vazhdojnë të kenë marrëdhënie të acaruara mes tyre. Dje në mbledhjen e komisionit parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, deputeti socialist i Përmetit braktisi mbledhjen në mënyrë demonstrative, gjatë kohës kur ministri Ahmetaj po bënte mbrojtjen e projektligjit të "Turizmit", pas kthimit të dekretit nga Presidenti Bujar Nishani. "Kjo mbledhje u shndërrua në gallatë. Unë s'merrem me gallata kështu që po iki fare", u shpreh



Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese

DEKRETET

"Mazhoranca ka rrëzuar me votat e saj në komisionet parlamentare dy dekretet e Presidentit për ligjin e "Turizmit" dhe atë të "Arsimit të Lartë". Seancën e të enjtes, Kuvendi pritet t'i rrëzojë të dy dekretet e Nishanit"

Kosta duke lënë mbledhjen. Nga ana tjetër, ministri Ahmetaj ju përgjigj se, "nëse e cilësoni ligjin e "Turizmit" gallatë, atëherë problemin e keni ju". Megjithatë max-

POLEMIKAT

"Deputeti i Përmetit, Vladimir Kosta dhe koordinatori i zgjedhjeve në Gjirokastrë, ministri Ahmetaj, u përfshinë dje në debate. Deputeti Kosta tha se ministri po bën gallatë dhe braktisi mbledhjen e komisionit"

horanca ka vendosur që dhe në seancën parlamentare të votojë kundër dekretëve të Nishanit. Çka do të bëjë që ligjet të hyjnë në fuqi dhe pa firmën e tij.



EUROPEAN UNION

The European Union Delegation to Albania is looking for an International Aid / Cooperation Officer

We are

The European Union (EU) is an economic and political partnership between 28 European countries. It plays an important role in international affairs through diplomacy, trade, development aid and working with global organisations. Abroad, the EU is represented through more than 140 diplomatic representations, known also as EU Delegations, which have a similar function to those of an embassy.

- The EU Delegation to Albania is a permanent diplomatic mission. The Delegation's main tasks are the following:
 - ◆ Facilitate the development of political and economic relations between the EU and Albania in the framework of the Stabilization and Association Process (SAP), which is the strategy for helping Albania in its path towards integration into the EU.
 - ◆ Managing EU Assistance programmes.
 - ◆ Disseminating information on the EU, informing the Albanian general public, decision makers and opinion formers about the integration process, EU institutions and its policies.

We offer

We offer a post of Programme Manager – EU Policies to ensure effective and efficient programming and implementation of Financial Assistance ensuring maximum impact to support the EU membership preparation to Albania. The selected person will support policy dialogue with all relevant ministries, agencies, donors and other relevant stakeholders in all areas of concern; contribute to the coordination of sector analysis and to the programming of activities under the instrument for Pre-accession Assistance (IPA). Contribute to the coordination of the analysis and implementation of the National Strategy for Development and Integration, the structure of Sector Working Groups and Delivery Units and the development of sector or programmes; Contribute to the coordination of programming, identification and appraisal in close cooperation with the beneficiary institutions in the country, if and when such programmes are decided in the programming process; Initiate and process all aspects of the procurement process drafting Terms of Reference, launching tenders, evaluating the bids, preparing the contracting file; encode contracts and give operational visa on documents where required; Monitoring ongoing projects, attend management and monitoring meeting, elaborate progress report on projects and propose action if and when needed and provide Certified correct for payments; Supervise and monitor procurement carried out by national authorities, contribute to Certified correct visa on payment requests from national authorities and to the clearance of accounts procedures; Coordinate procurement pipeline with national authorities; Support policy dialogue with all relevant ministries, agencies, donors and other relevant stakeholders in all areas of concern; Monitor and report on sectoral issues to the Head of Cooperation (including Early Warning on potential disputes); Contribute regularly and timely to the Delegation's reporting, as well as to any specific requests, including AODD reports, procurement and payment forecasts, monitoring, procedures, assurance strategy etc; Prepare and organise internal meetings with the Operational Sections, Contracts and Finance, Political and administrative sections; Oversee the systems and procedures for filing, archives and access to documents and internal control standards for the Operational Sections; In cooperation with the Communication officer of the Delegation, coordinate and propose production and dissemination of results of projects at workshops, seminars, conferences and other public events contributing to the achievement of the Delegation's objectives for the visibility of EC activities in the country; Support the Communication officer with the processing and planning of Communication and Information related projects and contract; Coordinate the access to documents through the EUD website; Extract and disseminate "best practice" and facilitate exchange of experiences; Writing of briefings and speech.

Place of employment will be Tirana, Albania. The length of the working week shall be 37h30. The post is of Group I with a starting basic salary of 240996 ALL per month.

We offer a competitive progressive career in an international environment. Benefits, such as additional medical insurance, are offered to employees and their families under certain conditions.

We look for

- ◆ Relevant University degree
- ◆ English (spoken and written) – high level (C1)
- ◆ Job related experience: at least 5 years of experience;
- ◆ Knowledge on Budget, Finance and Contracts

How to apply

Please send your application and supporting documents to:

Mrs Annamaria Bottini
Head of Administration
Delegation of the European Union to Albania
ABA Business Centre, 17th floor, Rr. Papa Gjon Palli II,
Tirana, Albania
Fax: +355 4 227 4410

The application should include a cover letter, a detailed CV, and relevant supporting documents and should arrive not later than **30 September 2015**. Short-listed candidates will be contacted by the Delegation before **7 October 2015**.

The Delegation will not supply additional information or discuss the selection procedure by telephone; please address any queries concerning this procedure to Delegation-Albania@eeas.europa.eu.



EUROPEAN UNION

The European Union Delegation to Albania is looking for Programme Manager – EU Policies

We are

The European Union (EU) is an economic and political partnership between 28 European countries. It plays an important role in international affairs through diplomacy, trade, development aid and working with global organisations. Abroad, the EU is represented through more than 140 diplomatic representations, known also as EU Delegations, which have a similar function to those of an embassy.

- The EU Delegation to Albania is a permanent diplomatic mission. The Delegation's main tasks are the following:
 - ◆ Facilitate the development of political and economic relations between the EU and Albania in the framework of the Stabilization and Association Process (SAP), which is the strategy for helping Albania in its path towards integration into the EU.
 - ◆ Managing EU Assistance programmes.
 - ◆ Disseminating information on the EU, informing the Albanian general public, decision makers and opinion formers about the integration process, EU institutions and its policies.

We offer

We offer a post of Programme Manager – EU policies to ensure effective and efficient programming and implementation of financial assistance in the area of Rule of Law and Justice and Home Affairs ensuring maximum impact to support the EU membership preparation of the beneficiary countries. Ensure fulfilment of sector/chapter reporting obligations based on communicated cross-section responsibilities. The selected person will support policy dialogue with all relevant ministries, agencies, donors and other relevant stakeholders in all areas of concern; Contribute to sector analysis and to the programming of activities under the instrument for Pre-accession Assistance (IPA). Contribute to the coordination of programming, identification and appraisal in close cooperation with the beneficiary institutions in the country, if and when such programmes are decided in the programming process; Initiate and process all aspects of the procurement process drafting Terms of Reference, launching tenders, evaluating the bids, preparing the contracting file; Encode contracts and give an "operational visa" (GESTOPE) on documents where required; Monitoring ongoing projects, attend management and monitoring meeting, elaborate progress report on projects and propose action if and when needed; Provide Certified correct for payments; Maintain contacts with other donors active in the country; Monitor and report on sectoral issues to Team Leader/ Head of Section (including Early Warning on potential disputes); Timely reporting related to sector reports, bi-monthly, Annual reports and ad-hoc reports related to the sectors covered as well as input for sub-committees, IPA MC, SAA, etc; Produce and disseminate the results of projects at workshops, seminars, conferences and other public events contributing to the achievement of the Delegation's objectives for the visibility of EC activities in the country; Extract and disseminate "best practice" and facilitate exchange of experiences; Prepare for occasionally drafting of briefings and speeches.

Place of employment will be Tirana, Albania. The length of the working week shall be 37h30. The post is of Group I with a starting basic salary of 240996 ALL per month.

We offer a competitive progressive career in an international environment. Benefits, such as additional medical insurance, are offered to employees and their families under certain conditions.

We look for

- ◆ Relevant University degree preferably in Law
- ◆ English (spoken and written) – high level (C1)
- ◆ Job related experience: at least 5 years of experience;
- ◆ Knowledge on Budget, Finance and Contracts

How to apply

Please send your application and supporting documents to:

Mrs Annamaria Bottini
Head of Administration
Delegation of the European Union to Albania
ABA Business Centre, 17th floor, Rr. Papa Gjon Palli II,
Tirana, Albania
Fax: +355 4 227 4410

The application should include a cover letter, a detailed CV, and relevant supporting documents and should arrive not later than **30 September 2015**. Short-listed candidates will be contacted by the Delegation before **7 October 2015**.

The Delegation will not supply additional information or discuss the selection procedure by telephone; please address any queries concerning this procedure to Delegation-Albania@eeas.europa.eu.

Nis gara për zgjedhjet e kryetarëve të PS-së

Shpallen kandidaturat e para, ja kriteret që duhet të plotësojnë pretendentët, kush përjashtohet

ESIONA KONOMI
TIRANE

Partia socialiste do të zgjedhë deri në 5 dhjetor të këtij viti 61 kryetarët e rinj të degëve të saj lokale për çdo bashki. Teksa rifreskimi i bazës së anëtarësisë e cila do të zgjedhë kryetarin degës sipas parimit "një anëtar-një votë", nëpër rrethe ka filluar gara mes emrave pretendentë. Për një nga degët më të rëndësishme të jugut, në Bashkinë Vlorë është shpallur kandidatura e parë. Ajo është një funksionar e vjetër e Partisë Socialiste në këtë degë, dhe quhet Evis Alushi, e cila ka njoftuar dhe nëpërmjet facebook-ut iniciativën e saj. Ajo ka shpallur edhe një pjesë të platformës së saj, teksa është në pritje të konkurrentëve të tjerë për të drejtuar degën socialiste të Vlorës. "Në procesin e nisur në PS të Vlorës, për zgjedhjen e kryetarit të partisë, ju bej me dije vendimin për të kandiduar për këtë detyrë politike. Bëj me dije se, për këtë vendim kam informuar dhe drejtuesin politik të Qarkut Vlorë, deputetin Koço Kokëdhima si dhe deputetët Mira Shehu dhe Fatmir Toçi, si dhe jam në kontakte me një numër të madh anëtarësh të PS", shkruan Alushi në faqen e saj në Facebook. Ajo më tej shpjegon marrëdhëniet e saj me politikën. "Jam ofruar në politikë, në PS Vlorë, në moshën 20 vjeçe dhe në gjithë këto vite kam kontribuar në shumë fushata, brenda dhe jashtë partisë. E kam përfaqësuar me din-



Kryeministri Edi Rama dhe Gramoz Ruçi

PROCESI

Kryetarët e degëve të PS-së në bashki, nuk do të jenë njerëz të punësuar, por persona që do të paguhen nga partia për punën që do të bëjnë.

jitet e integritet PS, dy mandate në Këshillin e Bashkisë, duke qenë së fundmi dhe Kryetare e Këshillit me 44 vota pro e asnjë kundër. Kam qenë zëdhënëse e PS në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011", vijon kandidata për drejtimin e degës së PS-së në Vlorë, Evis Alushi. "Për të gjitha këto kontribute e karriere politike brenda PS, mendoj se, kandidatura ime për detyrën e kryetarit të PS

Vlorë është në përputhje me kriteret e vendosura për këtë zgjedhje. Kam besimin se PS e Vlorës, sot më shumë se kurrë më parë, ka domosdoshmëri vlerësimitin dhe bashkimin e kontributeve të të gjithë atyre që i kanë dhënë jetë, fitore dhe vazhdimësi kësaj partie, në ditët e vështira të saj. Kam besim në mbështetjen që gëzoj në anëtarësinë e PS Vlorë", përfundon kandidata.

UDHËZIMI

Sipas udhëzimit të Gramoz Ruçit, kandidatët për kryetarë të degëve të PS-së në bashki, nuk do të jenë njerëz të punësuar, por persona që do të paguhen nga partia për punën që do të bëjnë. Ata duhet të kenë kontribut dhe angazhim politik të spikatur në të paktën dy vitet e fundit elektorale, dhe duhet të kenë përvojë në organizimin e strukturave lokale të partisë. Kryetarët aktualë të partisë në rrethe dhe njësi vendore, nuk do të jenë kandidatë në të gjitha rastet kur rezultati i zgjedhjeve të 21 qershorit, ka qenë humbës ose apo më i ulët se ai i zgjedhjeve paraardhëse. Nuk mund të kenë të drejtë kandidimi deputetët, kryetarët e bashkive, apo ministrat e Partisë Socialiste. Asambleja e zgjeruar e PS-së, e cila përfshin kryetarët e organizatave, delegatët e kongresit, kryetarin e këshilltarëve socialistë, kryetarin e forumit të graas dhe atij të rinisë, do të zgjedhë kryetarin e PS-së për bashkinë. Procesi zgjedhës do të kryhet me pjesëmarrjen e një të deleguar nga Asambleja Kombëtare. Ky proces mbyllet në 5 dhjetor dhe deri në 15 dhjetor do të zgjidhen dhe asambletë bashkiake të PS-së.



KANDIDATJA

Evis Alushi, ish-kryetare e Këshillit Bashkiak Vlorë, ka shpallur kandidaturën për tu zgjedhur në krye të degës së PS-së për bashkinë e jugut të vendit. Ajo ka nisur takimet me anëtarësinë.



KRITERET

Kryetarët aktualë të partisë në rrethe, nuk do të jenë kandidatë në të gjitha rastet kur rezultati i zgjedhjeve të 21 qershorit, ka qenë humbës ose apo më i ulët se ai i zgjedhjeve paraardhëse.

LAJME SHKURT



Meta në Tbilisi, takohet me homologun gjergjian

Kreu i Kuvendit Ilir Meta është pritur nga homologu i tij gjergjian në Tbilisi, David Usupashvili. Krahas vlerësimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, Meta kërkoi një bashkëpunim dypalësh më aktiv e më konkret, ku dy parlamentet mund të luajnë një rol parësor. Meta është shprehur se Shqipëria i mbështet plotësisht aspiratat euro-atlantike të Gjergjisë si një orientim i qartë në interes të paqes dhe stabilitetit në rajonin e Kaukazit. Ndërsa, Usupashvili shprehu mirënjohjen e Gjergjisë për mbështetjen e qartë të Shqipërisë.

Çuko për Ahmetajn: "Zoti President, mblihdhi qentë"

Këshilltari i Bujar Nishanit, Piro Ahmetaj, prej disa ditësh është përfshirë në polemika me deputetët e mazhorancës në Komisionin e Sigurisë. Ai ka thënë se disa prej tyre janë ish-sigurimsa, disa të tjerë kriminelë, trafikantë, tutorë prostitutashe e perversë. Ndërkohë, deputeti socialist Arben Çuko, është shprehur se vetë Ahmetaj ka qenë pjesë e Sigurimit të Shtetit. "Ahmetaj rezultoi të jetë bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit. Ne do i publikojmë veprimtarinë e tij si spiun dhe pseudonimin. Zoti President, mblihdhi qentë," shkruan deputeti socialist në Facebook.

Ambasadorja çeke: Më shumë vëmendje ndaj shkollave të veriut

Ambasadorja e Çekisë, Borislava Tomasova ka vizituar shkollën "Shtjefën Gjeçov Kryeziu" të fshatit Kryezi në bashkinë e Fushë-Arrzit. Në këtë fshat, ambasada çeke falë vullnetarëve të shoqatës Dajti Alpino Turistik mundësoj investimin për mjediset e jashtme të shkollës, këndet sportive, palestren dhe dy kabinetet bashkëkohore. Tomasova uroj që investimet të vihehin në funksion të nxënësve ndërsa ka shprehur dhe urar për më shumë vëmendje ndaj shkollave kryesisht në veriun e Shqipërisë. Kreu i bashkisë së Fushë-Arrzit, Fran Tuçi ka përgëzuar ambasadorën për kontributin e dhënë.



Koncesionet e naftës, 500 mln USD të pajustificuara në 2011

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore pretendon se vetëm për vitin 2011-të, kompanitë koncesionare që shfrytëzojnë naftën shqiptare kanë raportuar shpenzime të pajustificuara sa 4% e Prodhimit Kombëtar. "Nga kontrollat që ne kemi bërë gjatë vitit të kaluar, ne kemi evidentuar një shifër që është afër 500 mln dollarëve. Është një shifër që ka të bëjë me shpenzimet që kompanitë kanë kryer në mënyrë të parregullt dhe në forma jotransparente", thotë Dael Dervishi, kryetar i AKBN-së. Ai shton se nëse njëra nga palët nuk do të jetë dakort me gjetjen e ekspertit të pavarur "atëherë do t'i drejtohem arbitrazhit ndërkombëtar".

PR për raportin e OSBE: "Raport paçavure"



Partia Republikane e ka cilësuar "Raport paçavure", raportin e OSBE-së. Në njoftim e PR-së, hidhen poshtë përfshirjet e eksponentëve të kësaj partie në vepra të kundraligjshme: "Deputeti dhe kryetari i Asamblesë Kombëtare të Partisë Republikane, z.Agron Duka, nuk ka asnjë lidhje me akuzat të përdala të cituara në të ashtuquajturin "Raport". Gjithashtu në njoftim thuhet se "Ylli Vesel Shehu, ish deputet i PR-së, nuk ka paguar asnjë qindarkë për t'u bërë deputet i Partisë Republikane. Ndërkohë, akoma ky deputet rezultoi se nuk ka shlyer detyrime mediatike përkundërt subjekteve private, për fushatën e tij elektorale".

Ndryshon subvencionin i bujqësisë, tregtarët manipulojnë

Skema që kompenson Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për fermerët përmes tregtarëve të produkteve bujqësore do të ndryshojë. Një udhëzim i ri i Ministrisë së Financave, sanksionon se TVSH në masën 20% do t'ju kreditohet tregtarëve, që blejnë produkte nga fermerët, vetëm nëse këta

të fundit e kryjnë pagesën e blerjes së produkteve përmes bankës. Tatimet dhe Ministria e Financave thonë se skema filloi të deformohet dhe në vend që të përfitonin fermerët, TVSH-ja po merrej padrejtësisht nga tregtarët, të cilët paraqisnin fatura të manipuluar në Thesar.

Sali Berisha takim 50 minutësh me Bujar Nishanin

Detajet e takimit "tet a tet" në zyrën e Nishanit, shqetësim për raportin e OSBE

LEONARD QUKU
TIRANE

Ish-kryeministri Sali Berisha ka zhvilluar dje një takim kokë më kokë me Presidentin e Republikës, Bujar Nishanin në zyrën e këtij të fundit. Takimi i cili ka zgjatuar mbi 50 minuta, u mbajt jashtë vëmendjes së medias, çka bëri që si zyra e shtypit pranë Presidentit, ashtu edhe ajo e ish kreut demokrat, të mos prononcohen zyrtarisht për detajet dhe qëllimin e vizitës së Berishës në zyrën e Nishanit. Por burime pranë ish-kryeministrit Berisha, pohuan për Shqiptarja.com se në fokus të takimit ka qenë situata politike dhe raportin OSBE-së mbi aktivitetin dhe lidhjet e dyshuara me krimin e organizuar të politikaneve të rëndësishëm të vendit. Njëherazi me denoncimin e skandaleve të qeverisë dhe

thirrjen e protestave, Berisha është përfshirë edhe në një polemikë të ashpër me Prezencën e OSBE-së në vendin tonë, pas raportit të kësaj të fundit, i publikuar në media pa autorizimin e ambasadës, që flet për përfshirjen e familjes Berisha në biznese dhe aktiviteteve të paligjshme. Raporti i OSBE-së i publikuar 1 javë më parë, ka tronditur të gjithë politikën, pasi pjesa dërrmuese e politikanëve lakohen aty për veprimtari të paligjshme.

TAKIMI

Berisha mbërriti në Presidencën rreth orës 13:30 dhe

PËRPLASJET

"Njëherazi me denoncimet e "skandaleve qeveritare", ish kryeministri Sali Berisha është përfshirë edhe në një polemikë të ashpër me OSBE, raportin e së cilës e quajti kolektor të ujërave të zeza dhe akuzoi ambasadorin për njëanshmëri"



Ish-kryeministri Sali Berisha dhe Presidenti i Republikës, Bujar Nishani


doli nga aty në orën 14:20. Zyra e shtypit pranë Presidentit konfirmoi takimin mes Nishanit dhe Berishës, por nuk dha detaje rreth bisedës mes tyre. Por, burimet deklaruan për gazetën se qëllimi i vizitës ka qenë situata politike në vend, çështja e dekriminalizimit dhe reformës në drejtësi, si dhe raportin e OSBE-së për aktivitetin e politikaneve, dhe dyshimet që hedh ky raport për lidhjet e mundshme me krimin e organizuar.

Në seancën e fundit të Kuvendit, Berisha ka denoncuar përfshirjen e përfaqësuesve të qeverisë në skandale të rënda,

si ato të trafikut të drogës dhe korrupsionit, duke i bërë thirrje organit të akuzës për nisjen e hetimeve. Por, njëkohësisht me shqetësimin e tij për "skandalin qeveritar", Berisha ka hedhur akuzë të ashpura edhe ndaj ambasadës së OSBE dhe kreut të saj në Tiranë, Florian Raunig. Përmes një letre të gjatë, Berisha e quajti raportin e OSBE kolektor të ujërave të zeza, ndërsa akuzoi ambasadorin për njëanshmëri, pasi sipas tij nuk ka theksuar në dokument që për çdo akuzë politike në adresë të familjarëve të tij, ka folur gjykata, e cila i ka rrezuar ato si të pavërteta.

REAGIMI

Padia e bashkisë së Kukësit, Halilaj: Hakmarrje primitive



Ish kryetari i bashkisë së Kukësit, Hasan Halilaj e ka quajtur "hakmarrje primitive" padinë e bërë nga pasardhësi i tij, Bashkim Shehu. Në një prononcim për mediat, Halilaj ka thënë se i është kërkuar të heqë dorë nga gjyqi për shpifje ndaj deputetit të Partisë Demokratike Flamur Noka, që të mos ketë padi nga institucionet e bashkisë, e cila drejtohet nga demokratët "Kuksianët do të shohin më së miri se zotëria në fjalë, kush është dhe çfarë do të përfaqësojë dhe kush ka qenë qëllimi i ardhjes së tij në Kukës", ka deklaruar ish kreu i bashkisë së Kukësit, Hasan Halilaj.

DEPUTETI

Braçe ironizon Bashën: Ka nisur të gënjejë edhe për motin



Deputeti i PS-së Erjon Braçe ka ironizuar deklaratat e kreut të opozitës Lulzim Basha lidhur me anëtarësimin e PD-së me të drejta të plota në PPE. "Lulzim Basha është rënduar! Tani nuk gënjen më "për orën"! Tani të gënjen edhe për motin. Ti e pyet pasi sheh diellin: Si është koha! Ai pa pik turpi të thotë: Me shi! Arta e pyeti për "anëtarësimin me të drejta të plota të PD në PPE" që nuk ekziston gjëkund; Ai pa pikën e turpit i thotë: Anëtarësimi i plotë do të ndodhë kur Shqipëria të jetë vend anëtar i BE, kur vetë kish thënë se "PD anëtarësohet me të drejta të plota në PPE", fiks një javë më parë", shkruan deputeti Braçe në Facebook.

DENONCIMI

"Zgjedhjet e 21 qershorit dhe procesi i dekriminalizimit kanë qenë ankesat e kryetarit demokrat, Basha në takimet me eurodeputetët Kukan dhe Fleckenstein si dhe zyrtarë të lartë të Bashkimit European"



Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha

Seanca në PE

TIRANE

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha deklaroi dje pas seancës dëgjimore në Komisionin e Jashtëm të PE ku u diskutua raportin e ODIHR për 21 qershorin, se Partia Demokratike do të largojë të gjithë të inkriminuarit nga funksionet drejtuese. Kreu demokrat ka ndarë shqetësimin me eurodeputetët për mungesën e vullnetit nga ana e mazhorancës për të nisur procesin e dekriminalizimit, ndërsa ka shprehur sërish ankesat e opozitës, për zgjedhjet e 21 qershorit, që sipas tij, siç vëren edhe raportin e ODIHR, cenuan standardet. Ndërkaq, pak ditë pas ngritjes së komisionit të PD për verifikimin e figurës së drejtuesve të lartë të saj dhe të deputetëve, Basha premtoi nga Brukseli se do t'i shkojë deri në fund procesit të dekriminalizimit, pasi sipas tij, pa fituar këtë betejë, Shqipëria nuk mund të ecë përpara. "Partia Demokratike dhe unë personalisht jemi të vendosur që duke nisur

Basha: Largojmë të inkriminuarit nga funksionet drejtuese

Kreu i PD ankohet te zyrtarët e PE për zgjedhjet dhe dekriminalizimin

me procesin e dekriminalizimit të çojmë deri në fund përjashtimin nga çdo funksion drejtues çdo person të zgjedhur apo të emëruar me rekorde kriminale nga qeveria aktuale dhe ne këtë mënyrë të hapim një kapitull të ri edhe për zgjedhjet si testi kryesor i funksionimit të një demokracie. Sot nga Brukseli kam një mesazh për qytetarët shqiptarë; betejë për dekriminalizimin duhet të fitohet

sepse është një gjordiane ku lidhen të gjitha problemet e tjera të Shqipërisë si vota e lirë, ekonomia, varfëria dhe lufta kundër saj, papunësia, mirëqenia. Pa fituar këtë betejë Shqipëria nuk mund të ecë përpara", u shpreh Basha.

ZGJEDHJET

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha tha se kjo është hera e parë pas 13 vjetësh që Sh-

qipëria shënohet si vendi që nuk garanton votën e lirë të qytetarëve. Zgjedhjet e 21 Qershorit, tha Basha, përballen qytetarët dhe opozitën me forcën e plotë të një makinerie shtetërore të fortifikuar me ndihmën e krimin, bandave dhe parave të drogës e korrupsionit. "Është një skaner i plotë i gjendjes në Shqipëri që ka kulmur me kapjen dhe rrëzimin e zgjedhjeve të 21 Qershorit,

standardeve zgjedhore. Për herë të parë në 13 vite Shqipëria shënohet si një vend ku nuk garantohet vota e lirë e qytetarëve, vota pa frikë nga ndëshkimi qeveritar", tha Basha. Komentet e tij, kryetari i PD i bëri pas takimeve me europarlamentarët raportues për Shqipërinë Eduard Kukan dhe Knut Fleckenstein si dhe me zyrtarë të lartë të Komisionit dhe institucioneve të tjera evropiane.

Rama: Furnizim me ujë të pijshëm nga Shqipëria për rajonin e Pulias

Emiliano: Projekti do rrëzojë barrierat, ku shumë italianë duhet të vizitojnë Shqipërinë



Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti i rajonit të Pulias Michele Emiliano

EMIGRANTËT

"Ata, që në momentin e mbërritjes së anijes krijuan një shqetësim të madh e shumë frikë janë integruar më së miri dhe kontribuojnë në PBB-në italiane me një shumë që arrin 3.2 miliardë euro taksa".

BIZNESI

"Në Shqipëri ka ujë me një cilësi të mirë. Mund të jetë një ndër projektet më të mëdha mes Shqipërisë dhe Italisë. Shumë italianë duhet të vizitojnë Shqipërinë, kjo falë tarifave shumë të lira".

Kryeministri Edi Rama i ftuar në takimin ndërkombëtar "Rrugët e reja të Levantes" premtori të japë ujë të pijshëm për Pulian. Sipërmarjet e vendeve të jugut e sfida e internacionalizmit, që u organizua dje gjatë panairit "Fiera del Levante", në qytetin e Barit ka bërë një propozim të guximshëm. Në takim me presidentin e rajonit të Pulias, Michele Emiliano, Rama ka propozuar një bashkëpunim mes dy vendeve duke shfrytëzuar burimet natyrore të Shqipërisë e atësinë inxhinierike të Italisë. Bëhet fjalë për krijimin e një menaxhimi të përbashkët të rezervave ujore, ku Shqipëria do t'i ofrojë Pulias furnizim me ujë të pijshëm. "Jemi të lidhur natyrshëm gjeografikisht, e

PËRURIMI

Në Fiera del Levante dhe rruga "Shqipëria"



Nga dje tabela në Fiera del Levante të Barit, simbolin e marrëdhënieve të hershme tregtare mes Italisë e vendit tonë, do bëjë që të ndihen krenarë shumë shqiptarë! "Viale Albania" (Rruga Shqipëria) u inaugurua në një ceremoni të posaçme ku mori pjesë kryeministri Rama, presidenti i Rajonit të Puglias Emiliano dhe kryetari i bashkisë së Barit Antonio Decaro. Ajo ndodhet brenda territorit prej 280 mijë m² të panairit ndërkombëtar "Fiera del Levante". Presidenti Ugo Patroni Griffi, theksoi se "ky takim ndërkombëtar, është një tregues konkret i interesit të shtetit e sipërmarrjeve ndaj hapjes së tregjeve e individualizmit të rrugëve të reja në zhvillimin e rritjen e shoqërive italiane".

unë pata kënaqësinë e madhe të takojta guvernatorin Emiliano me të cilin biseduam për një projekt të madh për ujë. Ne kemi shumë burime ujore, e Puglia ka shumë njohuri për administrimin e ujit, ku ky i fundit i mungon. Atëherë duhet të tentojmë t'i japim jetë një kompanie shumëkombëshe, e para në llojin e vet, e cila mund të sjellë përfitime reciproke duke shfrytëzuar burimet e mëdha ujore të Shqipërisë dhe burimet e mëdha në dije të Puglia-s", tha Rama. Ai reklamoi cilësinë e shkëlqyer të ujit në Shqipëri, vlerësim që e ka ripërsëritur dhe presidenti puliez. "Në Shqipëri ka ujë me një cilësi të mirë. Kemi menduar që ky mund të jetë një ndër projektet më të mëdha midis Shqipërisë dhe Italisë. Ky projekt shpresojmë që të rrë-

zojë dhe barrierat, ku shumë italianë duhet të vizitojnë Shqipërinë kjo dhe falë tarifave shumë të lira", u shpreh Emiliano. Gjatë këtij takimi, Rama ka theksuar se janë 40 mijë biznese të vogla në Itali të drejtuar nga shqiptarët që japin një kontribut prej

Rama bashkë me presidentin e Rajonit të Puglias dhe kreun e bashkisë së Barit, inauguruan bulevardin me emrin "Shqipëria"

3.2 miliardë euro në vit me anë të taksave. "Sot ai imazh apokaliptik i para 25 vjetëve që qarkulloi në mbarë botën, me anijen më të mbushur në historinë e lundrimit, me shqiptarë që derdeshin në brigjet puljeze, duket se i përket një epoke tjetër gje-

ologjike. Dhe të gjithë ata, që në momentin e mbërritjes së anijes krijuan një shqetësim të madh dhe shumë frikë janë integruar më së miri dhe kontribuojnë në PBB-në italiane me një shumë që arrin 3.2 miliardë euro taksa. Këto janë të dhëna zyrtare të 2014-ës.

Nga kjo pikë-pamje, mendoj se shqiptarët janë integruar plotësisht, dhe emigracioni ynë ka hyrë në librat e historisë që na mëson se emigracioni është gjithnjë një burim rritjeje si për vendin e origjinës ashtu dhe për vendin pritës. Nga ana tjetër, gjërat kanë ndryshuar shumë sigurisht. Sot janë më shumë se 20 mijë italianë që punojnë në Shqipëri", tha Rama.

LAJME SHKURT



Gjysma e kredisë, me maturitet afatshkurtë ose afatmesëm

Kredia me maturim afatshkurtë, brenda një viti, zë afro 35% të totalit të kredisë të dhënë nga sistemi financiar, ndërsa kredia me maturim afatmesëm, deri në tre vjet, zë mbi 16% të totalit. Kjo strukturë e kreditimit të ekonomisë e vendos sistemin bankar përpara sfidës për të rritur kredinë e re me norma të larta, për të mund të sigurojë një rritje pozitive të portofolit të huave. Fakti që rreth 35% e gjithë kredisë maturonhet brenda një viti kërkon që kreditimi i ri të jetë mjaft dinamik dhe ruajtja e rritjes së stokut të kredisë nuk është e thjeshtë.

Komuniteti i Energjisë: Pavarësia e ERE, e ndikuar nga politika

Vendimarrjet e Entit Rregullator të Energjisë nuk i shpëtojnë dot ndikimeve të politikës. Në këtë përfundim del raporti i Komunitetit të Energjisë i publikuar pak kohë më parë nën titullin "Pavarësia e Rregullatorëve Kombëtarë në Komunitetin e Energjisë", ku sillet edhe një këndvështrim kritik. Raporti analizon statusin e pavarësisë të Autoriteteve Kombëtare rregullatore në Komunitetin e Energjisë. Në të mbulohen palë të përfshira si Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.



BB: Në Shqipëri 48% e të punësuarve, informal

Tregu i punës në Shqipëri në sektorët jobujqësore është 48% në informalitet. Shifrat i ka dhënë Banka Botërore në një studim të posaçëm të publikuar kohët e fundit për tregun e Punës në Shqipëri. Raporti i publikuar në maj 2015, ka të dhënat nga viti 2011 deri në 2013 dhe 2014. Raporti i Bankës Botërore vëren se cilësia e punësimit është e ulët dhe se informaliteti është mjaft i përhapur. Studimi i Bankës Botërore vlerëson se, në sektorin e ndërtimit 70% e të punësuarve nuk deklarohen, në sektorin e shërbimeve madhësia e informalitetit është 35% dhe në sektorin e industrisë është 46%.

Haxhinasto: Sigurimi i shitjes së biletës, redukton informalitetin



Sigurimi i shitjes së biletave tek pasagjerët është hapi i parë në betejën e nisur kundër informalitetit. Kështu u shpreh ministri i Transporteve Edmond Haxhinasto, gjatë një inspektimi që ka bërë në terren në stacionet e autobusëve të Tiranës. Ministri tha se paketa e masave kundër informalitetit në sektorin e transportit do të miratohet javën që vjen nga qeveria dhe do të rregullojë një sërë problematikash. Ministri foli gjithashtu për reformën e transportit ndërqytetas, duke thënë se synon një standart shumë më të lartë transporti për qytetarët.

BSH: Kreditë e humbura ulen me 10% gjatë 2015-ës

Niveli i kredive të humbura është ulur me 10% që nga fillimi i vitit 2015, sipas Bankës së Shqipërisë. Nga rreth 70 miliardë lekë që ishin në Janar, kreditë e humbura kanë zbritur në pak më shumë se 62 miliardë lekë në fund të muajit korrik. Fshirja e kredive të humbura u nxit nga miratimi i ligjit për tatimin mbi të ardhurat, duke saktësuar kushtet që kreditë e fshira të njëlloshin si shpenzime të zbritshme për qëllime fiskale dhe ndryshimi i rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë, nga BSH-ja, duke përcaktuar qartë se kreditë e humbura nuk mund të mbahen në bilanc më shumë se tre vjet.



AKEP miraton rregullore për tarifat postare

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka miratuar rregulloren që përcakton se tarifat që aplikohen për shërbimin postar universal, nga operatorët në vend, duhet të jenë të llogaturna në bazë të një metodologjie të qartë, që ka në bazë kostot por edhe një marzh logjik fitimi. Stipas kësaj rregullore tarifat vendosen mbi bazën: të jenë të përballueshme; të jenë të orientuara drejt kostos; të jenë të njëjta për shërbime të njëjta në të gjithë territorin e vendit; të jenë transparente dhe jodiskriminuese, të mos dëmtojnë konkurrencën. AKEP saktëson se mund të ndërhyjë kur tarifat janë të ekzagjuara.

Shkodër, gazetarët të pafuqishëm dhe në prehër të rutinës

Pronarët e TV private, protagonistë direkt në zgjedhjet vendore

ARBEN LAGRETA
SHKODËR

Megjithëse është qyteti që, pas Tiranës, ndoshta ka numrin më të madh të televizioneve private me edicione të rregullta informative - katër të tillë, pa llogaritur TV Koplikun, si dhe një TV që transmeton vetëm klipe këngësh popullore - Shkodra mbetet qyteti, ku të vërtetat e hidhura, që meritojnë të publikohen, vijojejnë të qarkullojnë nëpër kafene apo nën buzët e njerëzve, që flasin në mejhane, ndërkohë që, aty ku duhet, flasin me vete. Shkodra është ndoshta një ndër rastet e pakta, dhe ndoshta i vetmi qytet i rëndësishëm në vend, ku në dy fushatat e fundit elektrale, zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit 2013 dhe ato lokale të 21 qershorit 2015, pronarët e thujse të gjithë televizioneve private të saj ishin protagonistë direkt të tri forcave kryesore politike, si kandidatë për deputetë. Këtu bën përjashtim vetëm një televizion i hapur në fillim të vitit 2014, pronari i të cilit nuk është i lidhur, të paktën deri tani, me politikën dhe në të njëjtën kohë televizioni i të cilit po bën përpjekje serioze për një drejtim ndryshe, jo vetëm përsa i takon paanshmërisë në edicionet e lajmeve, por edhe në programacion, duke shfrytëzuar risitë e shumta teknologjike që ofron sot tregu.

Duke iu rikthyer ndikimit

apo, më mirë, ndërhyrjes së padiskutueshme të politikës në dem të informimit të paanshëm të publikut, mund të theksoj pa dyshim se të paktën në këto dy palë zgjedhjet e fundit, për arsyt që shtrova më lart, TV Rozafa dhe TV1 Channel kanë mbajtur qëndrime radikale dhe lehtësisht të njëanshme në krah të kandidatëve të tyre të preferuar politikë, duke shkelur kështu me dy këmbë minutazhin që ia lejon ligji për balancim ndërmjet kandidatëve kryesorë. Aq i theksuar ka qenë ky fenomen në këto dy televizione, sa që aty nuk u transmetua as edhe një minutë në kronikat e lajmeve nga fushata që një kandidat i pavarur për kryetar bashkie ose kandidati i tretë, përveç dy kandidatëve kryesorë femra, zhvilloi në zgjedhjet lokale të 21 qershorit të këtij viti në Shkodër. Në këto kushte, imagjinohet lehtë se sa pak ose aspak kanë në dorë të bëjnë gazetarët, që punojnë krejtësisht të pambrojtur në

DETYRIMI


Në tregun e vakët mediatic të Shkodrës kalimi i gazetarëve nga një televizion në tjetrin shoqërohet me shndërrimin e tyre me pahir nga të djathtë në të majtë apo edhe anasjelltas

RAPORTIMI

Në një pjesë të mirë të qendrave të votimit në Shkodër nuk kishte kabina të izolura votimi, por minipodiume. Si ka mundësi që 4 televizione lokale nuk u ndalën fare në këtë shkelje flagrante?

të tilla media vizive, ku duhet patjetër të zbatosh parimin absurd: "O me ne, o me ata"! Dhe, në rastet jo të pakta kur në tregun e vakët mediatic të Shkodrës, i cili i ngjjet më tepër një kënetë, kalimi i gazetarëve si topa ping-pongu, sa në një televizion në tjetrin, shoqërohet edhe me shndërrimin e tyre me pahir nga të djathtë në të majtë, të majtë të një lloji tjetër apo anasjelltas.

Për të vërtetuar më mirë pafuqinë, por edhe paafësinë e gazetarëve në Shkodër për të kapur thelbin e një shqetësimi real, për më tepër në një ditë jo të zakonshme, po jap vetëm një shembull ditën e zgjedhjeve lokale të 21 qershorit. Në një pjesë të mirë të qendrave të votimit në Shkodër nuk kishte kabina të izolura votimi, sipas standardeve të ruajtjes së privacisë, por vetëm minipodiume, që kushdo mund t'i shohë në zyrat e Postës Shqiptare. Në këtë mënyrë, ishte cenuar e drejta e fshehtësisë së votës



Qyteti i Shkodrës

dhe zgjedhjet në këto kushte duhej të anuloheshin qysh në minutën e parë nga vëzhguesit e çdo partie. Askush nuk ishte ankuar për këtë shkelje të minutës së parë të privacisë ende pa filluar votimi. Por ajo që të bën të revoltosh është se si ka mundësi që katër televizione lokale, që operojnë brenda vijave të verdhra të qytetit të Shkodrës, nuk u ndalën fare në këtë shkelje flagrante, ndërkohë që ishin të vëmendshëm - deri në neveri - edhe në rast se ndonjë kandidat për kryetar bashkie, apo edhe thjesht ndonjë militant politik në shërbim të fushatës do t'i shkelej këmba gabimisht nga kundërshtarët politikë?! Pavarësisht se këtu kemi të bëjmë edhe me një moskokëçarje kolektive dhe me problem, që ne shqiptarët i vuajmë masivisht si shoqëri, kritikim më të mëdha në këtë rast u faturohen

gazetarëve, sepse të paktën atyre të "krahut opozitar" do t'u shkonte edhe për shtat që ta trajtonin menjëherë në kohë këtë fenomen. Por, rendja sipas një plani - rutinë dhe të kopsitur ende pa filluar mirë punën bën që paafëzia apo edhe menefregizmi në emër të pagave jodinjtoze që marrin bën që të ulet këmbëkryq në prehrin e gazetarisë që bëhet në Shkodër.



Ky shkrim është përgatitur në bashkëpunim me Observatorio Balcón e Caucaso për Qendër Europiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF), bashkëfinancuar nga Komisioni Evropian. Përbajtja e shkrimit është përgjegjësi vetëm e Shqiptarja.com dhe nuk mund të pretendohet në asnjë mënyrë se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

LAJME SHKURT



Fshati Boks në protestë: Kompania po shkatërron kalanë për minerale

Banorët e fshatit Boks në Postribë të Shkodrës janë rikthyer protestave kundër firmës italiane që ushtron aktivitetin në një gurorë pranë kalasë së Drishtit. Banorët pohojnë se firma italiane po shkatërron kalanë shekullore të Drishtit. Gjithashtu, banorët shtojnë se kompania po nxjerr në mënyrë të fshehtë minerale të çmuara nga kjo zonë. Banorët kanë bllokuar makineritë e firmës italiane dhe kërcënojnë me përshkallëzim protestash nëse shteti nuk ndërhyr urgjentisht.

Ortodoksët kremtojnë Lartësimin e Kryqit të kisha e shembur

Besimtarët ortodoksë kanë kremtuar Lartësimin e Kryqit në rrënojat e kishës së Shën Thanasit në Dhërmi. Dhjetëra besimtarë, të shoqëruar nga prifti ortodoksë kanë vizituar gërmadhat e kishës, që u shemb nga UINUV më 26 gusht. Lartësimi i Kryqit, kremtuar në 14 shtator, përkujton gjetjen e Kryqit të Krishtit nga Shën Elena, nëna e perandorit Konstandin, në shekullin IV. Pasi u mor nga persianët, kryqi u rimor nga perandori Irakli, në shekullin VII, kur edhe u "lartësua" në Kishën e Ngjalljes në Jerusalem. Ky ritual vijon akoma edhe në ditët e sotme.

Mynih, protestë para ekspozitës së Ramës: Braktiseni siç bëri me ne

Vizita e Kryeministrit Rama në Gjermani nuk është mirëpritur nga të gjithë. Organizata 'REAGO' me në krye Leonard Dedej, u revoltua nga sjellja e kryeministrit. Sipas tij, Rama tregoi neglizhencë dhe mungesa e interesi ndaj refugjatëve shqiptarë, të cilët janë strehuar në kampin e azilantëve në Gjermani. Dedej u angazhua edhe dje, duke shpërndarë broshura para ekspozitës së kryeministrit në Mynih. "Ju nuk e keni idenë kush është Rama dhe faktikisht nuk keni pse ta dini, por nëse doni të na ndihmoni ne, atëherë refuzojnë dhe braktiseni punën e tij, ashtu siç ai ka braktisur popullin e vet", shkruhej në një broshurë.



Publikohen datat e konkurrimit për bursat në SHBA

Në kuadër të programit të "Youth Exchange and Study", ambasada amerikane në Tiranë, ka publikuar datat e fazës së parë të konkurrimit për të gjithë nxënësit e klasave 11 dhe 12 të gjimnazeve shqiptare, të cilët mund të përfillojnë një vit studimi me bursë falas në shkollat e mesme në Shtetet e Bashkuara. Faza e parë e konkurrimit do të zhvillohet në Tiranë më 4 nëntor dhe në Fier më 6 nëntor. Ambasada e SHBA-ve sqaron se pjesëmarrësit duhet të jenë të datëlindjes mes 1 janarit 1999 dhe 15 korrikut 2001, me rezultate të mira në shkollë dhe njohuri të anglishtes.

Mësuesit në protestë, u pushuan dhe u transferuan



Mësuesit e pushuar nga puna dhe ata të cilët janë transferuar e kanë vijuar dje protestën e tyre pranë Drejtorisë Arsimore, Librazhd. Ata kanë kundërshtuar largimin e pamotivuar nga puna. Kryetari i Federatës Sindikale të Arsimit dhe Shkencës, Xhaferr Dobrushi e cilësoi shkollën e Hotolishtit një rast të paprecedent, ku i gjithë stafi është larguar. Dobrushi tha se ndaj mësuesve po ushrohet terror. Në drejtorinë Arsimore të Librazhdit, mbërriti edhe një përfaqësi e Ministrisë së Arsimit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale të Elbasanit, të cilët zhvilluan një takim me drejtoreshën Fatbardha Qatja.

Aksioni kundër informalitetit, 300 tregtarë në protestë

Tregtarët e tregut industrial në Peshkopi kanë kundërshtuar aksionin e tatimorëve kundër informalitetit. Ata kanë mbyllur dyqanet dhe kanë zhvilluar protesta në rrugë. Janë rreth 300 tregtarë, të cilët kërkojnë që për momentin të trajtohen si tregtarë ambulantë për shkak të krizës me të cilën përballen. Ata

shtojnë se punojnë vetëm 8 muaj të vitit për shkak të kushteve të motit, ndërsa theksojnë se fuqia blerëse në këtë rreth edhe ndërm të ulëtat në vend. Protestuesit janë takuar edhe me drejtuesit e bashkisë dhe shtojnë se nëse kërkesat e tyre nuk merren parasysh, protestat do përshkallëzohen deri në greva urie.



Bursa trajnimi për të rinjtë shqiptarë në Gjermani

Valentina Leskaj ka zhvilluar një takim delegacionin e Bundestagut, në kuadër të një programi të përbashkët mes dy parlamenteve. Përfaqësuesja e Bundestagut gjerman deklaroi se ky projekt do t'ju japë shumë mundësi të rinjve për bursa dhe për tu punësuar. Deputetja gjermane tha se të rinjtë shqiptarë i jepet mundësia për të punuar në zyrat e deputetëve të Bundestagut dhe pjesëmarrje në seminare të ndryshme.



Bursa për të gjithë studentët më të mirë

Të gjitha shtete e huaja japin bursa për të rinjtë shqiptarë. Ministria e Arsimit thotë se deri tani janë me qëndrta studentët të cilët kanë përfutur bursa në një nga shtete e huaja. Pjesa më e madhe e aplikimeve janë mbyllur, por ka dhe shtete si polonia dhe Kroacia që pranojnë kërkesat për bursa apo për kurse të ndryshme. Një ndër kushtet kryesore është mesatarja mbi 8

Fituesit e fundit, kush mund të aplikojë me formularin A3

Regjistrohesh ata që janë fitues ose nuk janë regjistruar

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

Kandidatët që nuk janë shpallur fitues apo ata që kërkojnë të fitojnë një degë më të mirë, kanë shansin për të aplikuar me formularin A3. Ministria e Arsimit sqaron procedurën kush mund ta plotësojë formularin dhe kush përjashtohet. Nga data 24 deri në 28 shtator të gjithë kandidatët do të kenë mundësi për të plotësuar formularin ose për të aplikuar për ata që kanë fituar tashmë një degë.

MUND TË PLOTËSOJËN FORMULARIN A2

Maturantët që nuk kanë konkurruar më parë me formularin A2, por që në këtë raund do të konkurrojnë për herë të parë me formularin A3. Në këtë grup përfshihen kandidatët që: Kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2. Ata që kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2015. Mund ta plotësojnë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit dhe mbi bazën e ekuivalentimit

Regjistrimet Fluks në sekretariatë mësimore të fakulteteve



Më qindra studentë kanë mbushur sekretariatë e fakulteteve që në ditëne parë të regjistrimeve. Studentët fitues kanë preferuar që të mbyllin regjistrimin jo në ditën e fundit, kjo për shkak dhe të paralajmërimeve të MAS se ata që nuk regjistrohen humbasin degën që kanë fituar. Kandidatëve për tu regjistruar u duhet diploma e shkollës së mesme, dy fotografi, mandat pagesa prej 1600 lekësh dhe të plotësojnë një deklaratë me të dhënat personale. Afati i fundit i regjistrimit është data 19 shtator për të gjithë fituesit

të rezultateve të shkollës së mesme, kanë fituar të drejtën të aplikojnë për vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të parë në IAL-te publike në Republikën e Shqipërisë. Nga kandidatët e kategorive të sipërcituara, mund të aplikojnë në këtë raund, vetëm kandidatët që kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2015.

MUND TË APLIKOJËN EDHE:

Maturantët që kanë konkurruar në raundin e parë me formularin A2 (fitues ose jo dhe të regjistruar ose jo) dhe dëshirojnë të vazhdojnë garën për të qënë fitues ose për të kaluar në një preferencë më të lartë, duke ruajtur renditjen e preferencave të formularit A2 të plotësuar në raundin e parë,



nuk plotësojnë formular të ri, por vetëm shprehin vullnetin të vazhdojnë konkurrimin on-line. Nëse në përfundim, maturantët që është shpallur fitues në raundin e parë, nuk arrijnë të klasifikohet në një preferencë më të lartë, mbetet fitues në programin ku është regjistruar dhe vijon studimet e ciklit të parë.

NUK E PLOTËSOJËN

Përjashtohen nga konkurrimi në raundin e dytë, maturantët: Fitues në preferencën e parë të shprehur në formularin A2 dhe që janë regjistruar

në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve me dokumentacion përkatës. Përjashtohen edhe fituesit që kanë konfirmuar regjistrimin përfundimtar në preferencën e shpallur në fazën e parë të A2, nëpërmjet regjistrimit on-line, dhe që janë të regjistruar me dokumentacion në atë program studimi në raundin e parë të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plote, në programet e studimeve jouniversitare, profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

VENDIMI

MAS mbyll 6 shkolla private, 1 ditë pas nisjes së vitit shkollor



Ministria e Arsimit ka mbyllur 6 shkolla private. Vetëm një ditë pas nisjes së vitit shkollor 2015-2016 MAS ka vendosur të mbyllë një shkollë 9-vjeçare dhe 5 shkolla të mesme. "Pas kontroleve janë mbyllur shkollat private "Tole Alba", "Univers", dhe "Dituria" në Fier, shkollat "Dyrrahu" dhe "Pavarësia" me kohë të pjesshme në Durrës, si dhe shkolla 9-vjeçare "Vitrina" në Tiranë, - thotë Ministria e Arsimit. Mbyllja është bërë se këto shkolla nuk kanë plotësuar kriteret si dhe nuk kanë patur numërin e mjaftueshëm të nxënësve për të vazhduar vitin shkollor 2015-2016. Më herët Ministria Lindita Nikolla paralajmëroi mbylljen e disa shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, që nuk ofronin cilësinë e kërkuar. Sipas MAS kontrollohet do të vazhdojnë edhe për shkollat e tjera dhe ndaj atyre që nuk plotësojnë kriteret do të merren masa parajlmëruese deri në heqjen e licencës.

NISMA/ NË 22 SHTATOR KRYEQYTETI NUK DO TË KETË MAKINA

Veliaj: Bursa për nxënësit më të mirët e Tiranës

"Në buxhetin e ri të bashkisë do të propozojmë bursat"

Një takim me 100 nxënësit e shkëlqyer të shkollave të qytetit, kryebashkiaku Erion Veliaj u garantoi mbështetjen e bashkisë në promovimin dhe zhvillimin e aftësive të tyre. Veliaj tha se Bashkia e Tiranës do të ndër-marrë një sërë nismash që u vijnë në ndihmë të rinjve të qytetit, në veçanti atyre që janë më të mirët në mësim. Një prej nismave që kryebashkiaku Veliaj njoftoi ishte edhe rikthimi i bursave për të gjithë nxënësit e shkëlqyer. "Në buxhetin



Erion Veliaj me nxënësit e ekselencës

e ri të bashkisë do të propozojmë rikthimin e bursave për studentët më të mirë. Jo se ato para e nxjerrin një familje nga varfëria, jo se mjaftojnë për të plotësuar çdo dëshirë, por sepse është një mënyrë për të thënë që edhe taksapaguesit e Tiranës japin diçka për më të mirët e qytetit", u shpreh Veliaj, duke prezantuar edhe një nismë tjetër të bashkisë, siç është promovimi në publik i nxënësve më të mirë të shkollave të Tiranës, si një mënyrë për të treguar fytyrat e atyre që pu-

nojnë fort gjatë gjithë vitit shkollor. Një nisim tjetër e Kryebashkiaku është dhe krijimi i këshillit bashki-ak rinor të Tiranës me përfaqësues nga gjimnazat e Tiranës. Një tjetër nisim që do të ndër-marrë bashkia do të jetë "Tirana pa makina në 22 shtator". Sipas Veliaj në një ditë në kryeqytet nuk do të ketë qarkullim makinash. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, theksoi vëmendjen që qeveria i ka dhënë nxitjes dhe promovimit të nxënësve dhe studentëve më të mirë.

Peza: Drejtori i RTSH-së zgjidhet si Presidenti

Mazhoranca propozon ndryshim ligjor për zhbllokimin e situatës në televizionin publik

ESIONA KONOMI
TIRANË

Drejtori i Përgjithshëm i Televizionit Publik Shqiptar do të zgjidhet në të njëjtën mënyrë si Presidenti i Republikës. Pas më shumë se 1 vit dështim nga Këshilli Drejtues i RTSH-së, për të zgjedhur drejtorin, mazhoranca ka marrë iniciativën për të bërë ndryshimet e duhura ligjore që do të mundësojnë zhbllokimin e situatës. Sipas nënkryetarit të Komisionit të Medias dhe Mjeteve të Informimit Publik, Alfred Peza, me ligjin e ri që javën e ardhshme do të propozojë mazhoranca, zgjedhja e drejtorit të përgjithshëm do të bëhet me 4 raunde. Nëse në tre raundet e para, nuk arrihet zgjedhja e tij me shumicë absolute, në raundin e katërt, ai mund të zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Në rastet kur as kjo nuk arrihet, atëherë Këshilli Drejtues i RTSH-së do të duhet të shpërndahet, një formulë kjo që përdoret edhe me Parlamentin kur nuk arrihet të zgjedhë dot Presidentin. Peza e cilëson këtë hap si një ndryshim dhe nevojshme, më shumë sesa e dëshiruar, pasi sipas tij, opozita po e bllokoi procesin, dhe nuk i jep vetes shansin për konsensus dhe propozim alternative. Sa i takon pavarësisë së këtij televizioni nga qasja tradicionale pro-qeveritare, Alfred Peza ndan mendimin se nuk ka pse të jetë i kushtëzuar nga qeveria një institucion si TVSH, i cili është ekonomikisht i pavarur. Peza e konsideron këtë si një taktikë vetëfritimi dhe vetëpërdorimi nga ana e drejtuesve të RTSH-së.



Pavarësia
RTSH-ja nuk e ka problemin e pasjes së pavarësisë së saj tek ligji, por e ka tek një kulturë e vetëpërdorimit dhe e vetëfritimit ndaj qeverisë së radhës, pasi ashtu është mësuar të funksionojë që nga fillimet e pluralizmit e deri më sot.

Formula
Zgjedhja sipas meje do të jetë duke marrë modelin e formulës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, ku pas tre radhësh tentative për zgjedhje me shumicë absolute, në rast se nuk zgjidhet, në raundin e katërt, mund të zgjidhet me shumicë të thjeshtë.

Shpërndarja
Nëse përsëri nuk arrihet të zgjedhë drejtorin e përgjithshëm, atëherë këshilli të shpërndahet, siç shpërndahet parlamenti. Drejtori i përgjithshëm i RTSH-së, nuk është një person më i rëndësishëm se Presidenti që të zgjidhet me procedurë ekstra.

këshillit drejtues, dhe përmes përfaqësuesve të vetë opozita po e bllokoi procesin. Kjo do të thotë që ky proces nuk po mishëron konsensusin e premtuar dhe të prituar nga të gjithë, për t'i dhënë zgjedhje çështjes, dhe si një mundësi që opozita të ofrojë alternativa dhe në fund të fitojë alternativa më e mirë, dhe të kemi bashkëpunim. Këtë rast opozita e sheh si një mënyrë për ta bllokuar procesin, në mënyrë që ky proces të prodhojë kriza e nga kjo situatë

të përfitojë opozita. Në këto kushte, ne si ligjvënës jemi të detyruar të ndërhyjmë, pa dëshirën tonë, por të detyruar nga nevoja, por edhe nga koshiencia politike që kemi për të bërë reforma, pasi për këtë jemi votuar si mazhorancë, të ndërhyjmë dhe ta zgjidhim këtë ngërç. Do të zgjidhim këtë krizë të drejtitimit të RTSH-së, qoftë edhe duke e ndryshuar ligjin dhe për këtë jemi të vendosur.

Si do ta zgjidhë ndërhyrja ligjore këtë ngërç?

Një nga elementët është procedura e zgjedhjes së drejtuesit të RTSH-së. Ligjvënësit e mëparshëm, në perceptimin tim kanë bërë një gabim, pasi nuk kanë vendosur një limit të numrit të herëve që duhet votuar në mënyrë konsensuale për të zgjedhur drejtorin e përgjithshëm. Mund të votohet 100 herë apo 1000 herë, dhe ai mund të mos zgjidhet pafundësisht, dhe ligji aktual nuk jep zgjedhje se si mund të dilet nga ky ngërç. Zgjedhja sipas meje do të jetë duke marrë modelin e formulës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës, ku pas tre radhësh tentative për zgjedhje me shumicë absolute, në rast se nuk zgjidhet, në raundin e katërt, mund të zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Nëse përsëri nuk arrihet të zgjedhë drejtorin e përgjithshëm, atëherë këshilli të shpërndahet, siç shpërndahet parlamenti. Në fund të fundit, drejtori i përgjithshëm i RTSH-së, nuk është një person më i rëndësishëm se Presidenti i Republikës, ku procedura e zgjedhjes së tij të jetë më ekstra se e zgjedhjes së çdo drejtuesi tjetër institucioni. Gjykoj se kjo është një zgjedhje që jemi të detyruar ta bëjmë, për aq kohë sa ligji aktual nuk po shfrytëzohet si një shans për konsensus nga të dyja palët.

A do të shoqërohen këto ndryshime ligjore me një reformë tërësore në RTSH, përta përket dhe personelit?

Kjo çështje u përket vetëm strukturave drejtuese të televizionit, dhe nuk është fare kompetencë apo objekt i punës së deputetëve apo prej meje si nënkryetar i Komisionit të Medias dhe Mjeteve të Informimit Publik.

Meqë po bëhen ndryshime

ligjore për funksionimin e RTSH-së, a nuk është ky rasti për të bërë ndryshime të atilla ligjore, që do të siguronin pavarësinë e RTSH-së, e cila ka qenë në linjën editoriale përkrahëse e çdo qeverie?

RTSH-ja nuk e ka problemin e pasjes së pavarësisë së saj tek ligji, por e ka tek një kulturë e vetëpërdorimit dhe e vetëfritimit ndaj qeverisë së radhës, pasi ashtu është mësuar të funksionojë që nga fillimet e pluralizmit e deri më sot. E vetmja varësi që duhet të ketë ky institucion është ndaj shijeve dhe kërkesave të opinionit publik shqiptar, për sa kohë kontribuuesi kryesor për financat e këtij enti, është publiku shqiptar, dhe qeveria



Deputeti i PS, Alfred Peza

thujse nuk jep asnjë lek për këtë institucion. Nëse dikush ka pavarësi ekonomike, sigurisht që ka dhe pavarësi politike, por nëse dikush nuk dëshiron ta shfrytëzojë pavarësinë e tij ekonomike

për të rritur pavarësinë e tij politike, atëherë vetëfritimi apo vetpërdorimi i tyre do të jetë një mundësi për tu analizuar në instanca të tjera, ndoshta në psikoanalizë, por jo në politikë.



SHOQËRIA E PARË FINANCIARE E ZHVILLIMIT

Mikrokredi & Kredi

Produktet:

- Kredi individuale
- Kredi për Biznese të Vogla dhe të Mesme (SME)

Fushat e kreditimit:

- Kredi për bujqësi dhe mikro-ferma bujqësore
- Kredi për agro-industri
- Kredi për agroturizëm dhe turizëm familjar
- Kredi për blegtori
- Kredi jo bujqësore për zonat malore, rurale, urbane dhe peri-urbane, etj.



■ Harta e veprimtarisë së FAF

Tiranë
Durrës
Kavajë
Burrë
Bulqizë
Macedonare
Peshkopi
Elbasan
Gramsh
Librazhd
Pogradec
Korçë
Erenkë
Përmet
Tepelenë
Gjirokastrë
Sarandë
Lushnjë
Berat
Skrapar
Fier
Vlorë
Lezhë
Shkodër
Pukë
Kukës
Has
Tropojë
Mirditë

www.faf.al
E-mail: info@faf.al



FAF, zgjidhja juaj e prosperitetit

Zyra qendrore, Adresa: Rruga "Dervish Hima" nr.4 Tiranë, Tel: (355) (4) 2226027; 2224638

Vidhnin celularë me pistoletë lodër, në pranga

Ledio Çopa dhe Abdul Tusha u vidhnin telefonat turistëve kosovarë dhe durrsakëve



VJEDHJA

Dy të arrestuarit, më 29 Gusht të këtij viti, rreth orës 11:30 i kanë vjedhur me dhunë dy telefona "Samsung S5" dhe "Samsung S4" një 19-vjeçarit me iniciale J.H i cili banonte në Gjakovë



POLICIA

Dy të rinjtë, Ledio Çopa dhe Abdul Tusha u vidhnin telefonat personave të ndryshëm duke i kërcënuar me një pistoletë e cila pas arrestimit të tyre u konstatua se kishte qenë armë lodër



Materialet e sekuestruara nga policia

19-vjeçari me iniciale J.H i cili banonte në Gjakovë. Mësohet se J.H ka qenë i vetëm në një lokal në lagjen numër 13 në Durrës, kur dy personat e arrestuar e kanë kërcënuar me pistoletën lodër e më pas i kanë marrë dy telefonat. Por 19 vjeçari menjëherë ka bërë denoncimin në polici, ku nga hetimet dhe pamjet e sekuestruara nga kamerat

e lokalit rezultoi se autorë të vjedhjes ishin Ledio Çopa dhe Abdul Tusha. Sipas policisë së Durrësit, dy personat e arrestuar janë autorë edhe të disa vjedhjeve për të cilat po punohet për dokumentimin ligjor të tyre.

SEKUESTRIMI

Pas arrestimit të dy durrsakëve, policia gjeti në maki-

nën e 23-vjeçarit Ledio Çopës rreth 1 gramë heroinë e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Po ashtu, blutë e Durrësit gjetën edhe disa aparate celularë të markave të ndryshme që dy të arrestuarit u kishin vjedhur qytetarëve, si edhe u sekuestrua makina tip "Renault" me targa AA 706 ES. Gjithashtu, në makinën e Ledio Çopës,

Kërcënimi

Të prekur më shumë nga kërcënimet e dy të rinjve durrsakë ishin turistët, e kryesisht shtetasit kosovarë që pushonin në Durrës

policia gjeti edhe pistoletën lodër që dy të rinjtë përdorni për vjedhjet që bënin.

AKUZA

23-vjeçari Ledio Copa akuzohet për veprat penale të "Vjedhja me dhunë" dhe "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike". Ndërsa, 22-vjeçari Abdul Tusha akuzohet për veprat penale "Vjedhja me dhunë" dhe "bashkëpunim". Lidhur me rastet e denoncuar ndaj dy të rinjve të arrestuar, materialet e mëtjeshme tashmë i kanë kaluar Prokurorisë së Durrësit për hetime të mëtejshme.

XHENILA KODRA DURRËS

Dy djem të rinj kanë rënë në prangat e policisë së Durrësit sepse nën kërcënimin e një pistolette lodër vidhnin aparate celularë. Uniformat blu arrestuan 23-vjeçarin Ledio Çopa dhe 22-vjeçarin Abdul Tusha, të dy banues në Durrës. Sipas policisë lokale, këta dy persona, në bashkëpunim me njëri-tjetrin u vidhnin telefona qytetarëve duke i kërcënuar ata me pistoletë lodër. Më shumë të prekur nga kërcënimet e dy të rinjve durrsakë ishin turistët, e kryesisht shtetasit kosovarë të cilët kishin shkuar në Durrës për të kaluar pushimet e verës. Burime nga policia e Durrësit thanë se dy djemtë u zbuluan nga kamera e një lokali ku ata kishin kryer një vjedhje, ndërsa ndaj tyre kanë nisur edhe hetimet për raste të tjera të mundshme.

HETIMI

Pas një hetimi 1 mujor, policia në bashkëpunim me Prokurorinë e Durrësit në kuadër të operacionit të koduar "Shëtiteshi" vunë në pranga dy të rinjtë, banues në qytetin bregdetar. Burime nga policia lokale thanë se nga hetimet ka rezultuar që 23-vjeçari Ledio Çopa dhe 22-vjeçari Abdul Tusha, më 29 Gusht të këtij viti, rreth orës 11:30 i kanë vjedhur me dhunë dy telefona "Samsung S5" dhe "Samsung S4" një

LAJME SHKURT



Në pranga pronari i autobusit, nuk i paguan sigurimet shoferit


Një 54-vjeçar me iniciale Xh.K është proceduar në gjendje të lire nga policia e Elbasanit, pasi ka mashtruar në mënyrë të vazhdueshme 29-vjeçarin M.B, banues në Elbasan, 54-vjeçari Xh.K e kishte punësuar 29-vjeçarin M.B si shofer të mjetit e tij autobus për linjën Elbasan-Belsh, për transportin e mësuesve dhe nuk i ka paguar sigurimet shoqërore për nëntë muaj. Për këtë rast, materialet hetimore i'u kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për veprime të mëtejshme për veprën penale "Mashtrimi" dhe "Fshehja e të ardhurave".

Policia bizneseve: Kaska mbrojtëse për punonjësit me motor


Policia Rrugore e Tiranës u ka dërguar një letër një pjesë të bizneseve, ku i t'u kërkuar të mos lejojnë punonjësit e tyre të lëvizin në motor pa kokoren mbrojtëse. Në letër, paralajmërohet se do të ketë kontrollë të rrepta në këtë drejtim si dhe theksohet se punëdhënësi është përgjegjës për pasojat e rënda ndaj jetës dhe shëndetit të punëmarrësit. Sipas ekspertëve të Policisë Rrugore, ka ardhur koha që gjoba për mospërdorimin e kaskës mbrojtëse të 5 ose 10 fishohet si një mënyrë për të parandaluar aksidente fatale. Vetëm gjatë një viti, dhjetra motoçiklistë humbin jetën për shkak të mospërdorimit të kaskave.

Pranga kryeplakut, nuk raportoi kanabisin pranë shtëpisë

Kryeplaku 35-vjeçar i fshatit Temule në Vaun e Dejës u arrestua nga policia, pasi pranë banesës së tij u gjetën 6 parcela me 163 bimë kanabis. Sipas burimeve nga policia, kryeplaku Ndoj Vavaci mësohet të ketë shmangur përgjegjësinë për kultivimin e lëndës narkotike.



Gjithashtu, 53-vjeçari Xhelal Hasani dhe dy djemtë e tij 23 vjeçari Margen dhe 21 vjeçari Esati u arrestuan pasi pranë banesës së tyre u gjetën të kultivuara bimë narkotike dhe 1 armë automatik me dy kërehëra me fishekë. Në pranga ka rënë edhe 21 vjeçari Erhaid Nure, pasi u gjet bimë narkotike e kultivuar në banesë.



Trafikonin kokainë, arrestohet shqiptari dhe e dashura nga Ekuadori

Një 37-vjeçar shqiptar së bashku me partneren e tij nga Ekuadori, u arrestuan dje nga policia italiane, pasi në një apartament u gjetën 21 kg kokainë dhe 132 mijë euro. Sipas mediave italiane, shqiptari është identifikuar me emrin Irakli Kito. Ai e trafikonte lëndën narkotike mes qyteteve Pavia dhe Milano. Amalbalzhimin e drogës, Kito e bënte me markat e njohura të firmave si "Louis Vuitton", "Nike", etj. Ai është arrestuar në momentin që po përpunonte drogën, së bashku me 36 vjeçaren Maria Elena Meza Alvarado. Në apartament, u gjetën gjithashtu edhe pajisje për falsifikimin e logove të markave të njohura.

Trafiku i drogës, arrest me burg për dy fierakë



Masa e sigurisë arrest me burg është dhënë për dy personat e akuzuar për trafikimi ndërkombëtar të lëndëve narkotike, të kryer në bashkëpunim. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se lënda narkotike kanabis sativa sigurohej në zonat rreth fshatit Vjosë të Fierit nga Flori Hysaj, në sasia që variojnë nga 5-10 kilogramë. Hysaj e paketonte lëndën narkotike dhe ia dorëzonte atë bashkëpunëtorit të tij, Nardi Mecaj, i cili nëpërmjet një çante shpine bënte kalimin e drogës në territorin grek, duke kaluar në këmbë kufirin në zonën e gjelbërt.

Vrau fqinjin se i ngacmoi gruan, dënohet me 35 vite burg

Gjykata ka dënuar me 35 vite burg Azem Ukën, i cili më 1 shtator të vitit 2014, vrau me armë zjarri Berilon Kaçorin dhe plagosi rëndë të bashkëshorten e viktimës, Orjeta Kaçorin. Krime ndodhi në fshatin Lufaj të Mirditës, ndërsa vetë 30-vjeçari, i cili pranoi vrasjen, tha se e


ndërmorri këtë akt pasi e akuzonte Kaçorin se i ngacmonte të shoqen. Për shkak se i dyshuari e ka pranuar fajësinë dhe ka kërkuar gjykim të shkurtuar, prokuroria ka kërkuar dënimin e tij me 35 vjet burgim. Gjatë seancave gjyqësore, Uka nuk ka shprehur pendesë për krimin.

Mirditë, i kërkuari për vrasje qëllon me armë RENEA-n

Petrit Dushi i dënuar me 20 vite burg për vrasje, hetohet edhe për falsifikim

XHENSILA KODRA
TIRANE

Forcat operacionale të RENEA-s janë përballur me të shtëna me armë gjatë operacionit të zhvilluar në Mirditë për arrestimin e Petrit Dushit, i dënuar me 20 vite burg për vrasje. Kërkimet ngaj 44 vjeçarit janë përqendruar në fshatin Orosh të rrethit të Mirditës, por sapo Dushi konstatuar praninë e policisë në fshat është larguar menjëherë nga vendi ku qëndronte i fshehur, në drejtim të pyllit. Forcat e RENEA-s janë përgjigjur me të njëjtin monedhë duke shkëmbyer zjarr në drejtim të 44 vjeçarit. Mësohet se nga të shtënat nuk ka të lënduar, ndërsa dyshohet se i shumëkërkuari mund edhe të jetë plagosur. Burime nga policia thanë se efektivët e RENEA-s kanë bërë negociata me Petrit Dushin nëpërmjet familjarëve dhe të afërmeve të tij, por ai nuk ka pranuar të dorëzohet. Po të njëjtat burime shtuan më tej se ndërhyrja për vënien e tij në pranga është e vështirë për shkak të zonës së pyllëzuar që 44 vjeçari Petrit Dushi ka zgjedhur për t'u fshehur. Sipas informacioneve para-prake të policisë, mësohet se 44 vjeçari akuzohet edhe për veprën penale të falsifikimit. Për kapjen dhe vënien e tij në pranga janë dërguar edhe forcat të shumta policie nga ajri. Deri në mbrëmje, policia nuk ka arritur të verë në pranga Dushin, ndërsa ka



Petrit Dushi

rrethuar zonën ku ai është fshehur të vijuar operacionin përsëri sot.

KUSH ËSHTË PETRIT DUSHI?

44 vjeçari nga Mirdita,

Petrit Dushi është një emër mjaft i njohur për policinë shqiptare. Para 13 vitesh, në fshatin Kaçinar të Mirditës, Dushi vrau me armë zjarri bashkëfshatarin e tij pikërisht në ditën që viktimja kishte



Operacioni i forcave RENEA

POLICIA

Forca të shumta të RENEA-s janë përqendruar në fshatin Orosh të rrethit të Mirditës, ku kanë nisur një operacion për arrestimin e Petrit Dushit, i dënuar me 20 vite burg për vrasje

RASTET

Petrit Dushi vrau me armë zjarri bashkëfshatarin e tij 13 vite më parë për çështje pronësie, ndërsa në Tetor të vitit 2013 ai vrau me automatik kushëririn e tij që e kishte strehuar në shtëpi

martuar vajzën. Shkak i ngjarjes kishte qenë për çështje pronësie. Që prej asaj kohe, 44 vjeçari kishte jetuar në arrati, ku rrinte i fshehur në banesën e dajës së babait. Në Tetor të 2013-ës, Petrit Dushi doli sërish në "skene" ku emri i tij u përfol edhe për një vrasje tjetër. Dy vite më parë, në komunën Ungrej të Lezhës, Dushi kishte vrarë me armë dajën e babait të tij, Mark Jakun, i cili kishte qenë edhe personi që e kishte strehuar në shtëpinë e tij për një kohë të gjatë. Ditën e ngjarjes, 44 vjeçari Petrit Dushi kishte qenë duke pirë kafe në një lokal me kushëririn e tij Mark Jaku. Të dy kishin qenë në gjendje të dehur dhe më pas kishin nisur të debatonin ashpër me njëri-tjetrin.

Kishin qenë klientët e tjerë të cilët kishin ndërhyrë në mes tyre dhe menjëherë pas kësaj, Petrit Dushi ishte larguar nga lokali për t'u kthyer pak minuta më vonë me një automatik në dorë. Sapo kishte hyrë në lokal, ishte afuar te Jaku dhe ka qëlluar me breshëri në drejtim të tij, duke e lënë të vdekur në vend. Menjëherë pas kësaj ngjarjeje, 44 vjeçari ishte larguar me shpejtësi nga lokali dhe duke përfutur nga errësira tentoi t'i largohej policisë së Lezhës për t'u fshehur në zona të pyllëzuara. Sipas dëshmiave që personat që kishin qenë në lokal u raportua se Mark Jaku i kishte kërkuar Dushit që mos të qëndronte në banesën e tij, pasi kjo gjë implikonte edhe familjen e tij.

LAJME SHKURT

Shtyhet gjyqi ndaj imamëve të dyshuar për rekrutime

Seanca gjyqësore ndaj imamëve të Tiranës është shtyrë për të martën ejavës së ardhshme për shkak të mungesës së prokurorës së çështjes. Nëntë të pandehurit në këtë proces akuzohen se kanë rekrutuar dhe dërguar në Siri të paktën 70 besimtarë myslimanë shqiptarë, ku në vendin e luftës janë rreshtuar në krah të organizatave terroriste. Nga të dhënat e deritanism, dyshohet që të paktën 15 besimtarë janë vrarë gjatë luftimeve, ndërsa një numër i madh fëmijësh të këtyre besimtarëve, ndodhen në vendin e luftës. Mes të akuzuarve janë edhe dy imamët e vetëshpallur të xhamisë së Unazës së Re dhe Mzezit.



Laç, makina përplas motorrin, humbin jetën dy

Një aksident automobilistik me pasojë vdekjen e dy personave ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në hyrje të qytetit të Laçit në vendin e quajtur "shinat e trenit". Viktimat janë dy burra 40 vjeçarë. Xhevahir Abedini dhe Anton Gjinaj, të dy banues në Patok të Laçit. Viktimat kanë qenë duke udhëtuar me një motor në momentin që janë përplasur nga një automjet, ndërsa drejtuesi i mjedtit është larguar nga vendi i ngjarjes. Policia ka identifikuar shoferin dhe po punon për kapjen e tij.

Itali, arrestohen dy shqiptarë me drogë të lëngshme

Dy shqiptarë janë arrestuar nga policia italiane pasi u kapën në flagrancë me 23 kg drogë të lëngshme të llojit ketaminë. Njigjarja ka ndodhur në Verona, ku dy shqiptarët e kishin fshehur drogën e lëngshme në bagazhin e automjetit të tyre tip "Benz". Ketamina ishte vendosur në disa shishe plastike, të cilat



u zbuluan nga policia italiane pas kontrollit të automjetit. Raportohet se lënda narkotike në formë të lëngshme u dërgua në laborator për analiza të mëtejshme. Ndërsa, nuk është bërë i ditur identiteti i personave të arrestuar.

Shkëmbim zjarri mes kultivuesve të kanabisit dhe policisë



Shkëmbim zjarri ka ndodhur mes kultivuesve të kanabisit në Dukagjin dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë. Burime të policisë bëjnë me dije se gjatë aksionit antikanabis në Dukagjin, pronarët të parcelave të mbjella me lëndën narkotike kanë qëlluar me armë në drejtim të policisë dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë. Blutë janë kundërpërgjigjur me të shtëna në vendin e quajtur "Bjeshkët e Palajve". Personat që kanë qëlluar me armë ndaj policisë kanë mundur të largohen duke përfutur nga terreni i vështirë dhe errësira. Gjatë aksionit janë sekuestruar 200 rrnjë kanabis sativa.


70 vjeçari goditet nga një makinë, në gjendje të rëndë

Një 70 vjeçar u dërgua në gjendje kritike për jetën në spitalin rajonal të Shkodrës, pasi u përplas dje nga një automjet. Aksidenti u shënuar në lagjen "Qafë Hardhi" rreth orës 15:00, kur automjeti tip Eolksvagen me targë AA 887 ED që drejtohej nga Arjan Hoxha, përplasi 70 vjeçarin me inicialet P.D nga qyteti i Pukës. Mësohet se 70 vjeçari është shtruar në repartin e reanimacionit në terapi intensive, për shkak se plagët e marra nga përplasia me automjetin kanë qenë të shumta. Sipas grupit hetimor, dyshohet se i moshuari i ka prerë rrugën automjetit që drejtohej nga Hoxha duke u përplasur me të.

Tiranë, Bashkia gjobit 8 automjete qarkulluan jashtë orarit

Në ditën e dytë të zbatimit të urdhresës së nxjerrë për normalizimin e trafikut të automjeteve gjatë orëve kur kryhet mësim në shkollat e Tiranës, Policia Bashkiake ka konstatuar një sërë shkeljesh nga drejtuesit mjetesh, të cilët nuk u janë bindur ndalesave të nxjerra nga Bashkia.

Vetëm gjatë paradites së djeshme, Policia Bashkiake ka vendosur 8 gjoba për thyerjen e orarit të përcaktuar nga Bashkia Tiranë. Gjobat kanë variuar nga 3 mijë lekë e lartë dhe kryesisht janë vendosur për automjetet e bizneseve të ndryshme që kanë tentuar të kryejnë shërbime furnizimi gjatë fashës orare të ndaluar.



Rubrika

SHËNDETI

LEXIM I LEHTËSUAR

Për të ndihmuar njerëz në moshë të thyer rubrika "Shëndeti" botohet me gërmë më të madhe për të lehtësuar leximin

KESHILLAT

Si mund të trajtohet talasemia? Diagnostikimi

Njerëzit me forma të moderuara dhe të rënda të talasemisë zakonisht diagnostikohen që në fëmijëri, pasi ata kanë simptoma të anemisë së rëndë qysh herët në jetë. Njerëzit me forma më pak të rënda të talasemisë mund të diagnostikohen vetëm nëse kanë shenja të anemisë, ose nëse një mjek gjen aneminë në një test rutinë të gjakut të bërë për një arsye tjetër. Duke qenë se talasemia është e trashëguar, disa njerëz e zbulojnë atë pasi ata kanë të afërm me talasemi. Talasemia është me e zakonshme te njerëzit në vendet e Mesdheut, Azisë, Afrikës dhe Lindjes së Mesme. Nëse keni anemi dhe keni anëtarë të familjes nga këto zona, mjeku mund të testojë gjakun për të gjetur nëse keni talasemi. Talasemia është një çrregullim që mund të mirëmenaxhohet me transfuzione gjaku dhe terapi. Lloji i trajtimit që merr një person me talasemi varet nga sa e rëndë është talasemia. Një mënyrë për të trajtuar aneminë është furnizimi i trupit me më shumë qeliza të kuqe të gjakut përmes transfuzionit të gjakut. Transfuzioni i gjakut është i domosdoshëm për jetën e një talasemiku sepse:

- Ju garanton indeve dhe organeve sasi të mjaftueshme oksigjeni.
- Ndhmon palcën e kokave për të mos u sfocuar në prodhimin e rruazave të kuqe në mënyrë që kokat të rriten normalisht.
- Parandalon ose sforcion zmadhimin e shprekës dhe sforcimin e organeve të tjera.

Njerëzit me talasemi major zakonisht kanë nevojë për transfuzione të rregullta gjaku, ata me talasemi të mesme mund të kenë nevojë për transfuzione gjaku atëherë kur kanë një infektion apo një sëmundje, ndërsa njerëzit me talasemi minor zakonisht nuk kanë nevojë për transfuzion gjaku. Shumë herë njerëzve me talasemi ju rekomandohet edhe vitaminë B, e njohur si acid folik, për të ndihmuar trajtimin e anemisë. Trajtimi me acid folik bëhet zakonisht së bashku edhe me terapi të tjera. Sot, shërimi nga talasemia po bëhet gjithnjë edhe më i mundur nëpërmjet aplikimit të teknikeve mjekësore të sofistikuar.



4 hapat për ta "luftuar" talaseminë

Konsumi i ushqimeve me vlera ushqyese është i rëndësishëm për të gjithë

Talasemia është një sëmundje e cila ka prekur një numër të lartë personash edhe në Shqipëri. Sipas studimeve, një person me talasemi duhet të marrë parasysh zbatimin korrekt të skemës së vaksinimit, ngrënien e ushqimeve me vlera ushqyese, aktivitetin fizik dhe zhvillimin e marrëdhënieve pozitive.

VAKSINAT

Njerëzit me talasemi mund të marrin infeksione serioze, veçanërisht në qoftë se ata kanë hequr shprekën. Prandaj, një person me talasemi duhet të jetë gjithmonë vigjilent kur ka temperaturë apo ndonjë shenjë tjetër infeksioni. Kur te një person me talasemi shfaqen shenjat e infeksionit, ai duhet të kërkojë men-

jherë ndihmë mjekësore. Vaksinat ndihmojnë në mbrojtjen e një personi me talasemi nga shumë infeksione. Fëmijët duhet të respektojnë skemën e vaksinimit rutinë. Mjekët mund të rekomandojnë vakcina të tjera shtesë për të rriturit me talasemi.

USHQIMI

Konsumi i ushqimeve me vlera ushqyese është i rëndësishëm për të gjithë për një mënyrë jetese të shëndetshme. Një dietë e pasur me fruta dhe perime, si dhe me yndyrna të ulëta është ideale për të fituar ushqyesit thelbësor që ju nevojiten organeve tona. Për njerëzit që jetojnë me talasemi, duke qenë se kanë tepriç hekur në gjak, ushqimet e pasura në hekur duhet të kufizohen. Hekuri

mund të gjenden në mish, peshk dhe disa perime (p.sh. spinag). Produkte të tjera, si drithëra dhe lëng portokalli, mund të përmbajnë hekur shtesë. Personat me talasemi duhet të diskutojnë me mjekun e tyre nëse ata duhet apo jo të kufizojnë sasinë e hekurit në dietën e tyre.

AKTIVITETI FIZIK

Aktiviteti fizik është pjesë e një jetese të shëndetshme dhe ndihmon në tregues më të mirë shëndetësor. Edhe pse disa njerëz me talasemi mund të kenë vështirësi të marrin pjesë në forma të fuqishme të aktivitetit fizik, ata mund të marrin pjesë në aktivitete të moderuara fizike duke përfshirë ecjen me biçikletë, vrapimin dhe ecjen në këmbë. Nëse një person me talasemi ka probleme me kyçet e këmbëve, ai mund të merret me aktiviteteve të tjera të moderuara përfshirë joga, not apo gjimnastikë uji. Nëse keni talasemi, ju duhet të diskutoni me mjekun tuaj për nivelin e ushtrimit që është më i mirë për ju.

MARRËDHËNIE TË SHQËRORË

Të kesh marrëdhënie të ngrohta dhe mbështetëse është pjesë e rëndësishme e jetës. Miqtë, përfshirë bashkëpunëtorët, shokët e klasës dhe anëtarët e familjes, mund të ofrojnë mbështetje në menaxhimin e talasemisë (përshebull duke ofruar një udhëtim në qendrën e transfuzionit, kujtesa me delikatesë për planin/trajtimin/grafikun tuaj të trajtimit etj.) dhe ballafaqimin me stresin e jetës së përditshme. Përveç kësaj, në qoftë se keni talasemi, jeni bartës të saj, apo dini që dikush në familjen tuaj është me talasemi, këshillimi gjenetik rekomandohet para çfarëdo shtatzënie, në mënyrë që ju dhe partneri juaj të informoheni për rrezikun e të pasurit një fëmijë me talasemi.

SHENJAT E TALASEMISË

- Marrje mendsh
- Vështirësi në frymëmarrje
- Rrahje të shpeshta të zemrës
- Dhimbje koke
- Ngërçe muskulore
- Vështirësi në përqendrim etj

**KËSHILLAT
STUDIMET**

Rastet

Në qoftë se tensioni juaj i gjakut është mbi 120/80 mmHg, por më pak se 140/90 mmHg, jeni në rrezik për t'u bërë hipertensivë. Prandaj ju duhet të merrni disa hapa të menjëhershme



Tensioni i lartë

Në qoftë se tensioni juaj i gjakut është rreth apo mbi 140/90 mmHg, ju duhet të takoni një person të kujdesit shëndetësor për të parë nëse keni tension të lartë të gjakut

OBSS

Më shumë se një në tre të rritur në mbarë botën ka tension të lartë të gjakut, ose rreth 1.8 miliardë njerëz kanë hipertension.

Dieta

"Konsumoni një dietë të ekuilibruar dhe të shëndetshme bazuar në perime dhe fruta, drithëra, produkte ushqimore me pak yndyrë, peshk dhe bishtajore"

Tensionin e gjakut është një nga shqetësimet kryesore të të moshuarve. Shumë prej tyre nuk mund ta kontrollojnë tensionin e ulët ose të lartë dhe detyrohen që të përdorin kura të ndryshme që ju japin mjekët. Por studimet tregojnë se për të kontrolluar tensionin duhet që të keni parasysh shtatë këshilla. E para është që të reduktoni konsumin e kripës. Duhet të përdorni deri në 5 gramë kripë në ditë. Duhet të mbani një dietë të rregullt duke u mbështetur tek perimet frutat, drithërat dhe peshku. Gjithashtu, duhet që të shmangni përdorimin e alkoolit, mund të konsumoni vetëm pije që kanë përmbajtje shumë të ulët alkooli. Aktiviteti fizik është një tjetër këshillë të cilët japin studiuesit. Mesatarisht në ditë duhet të kryeni 30-60 minuta në ditë aktivitete fizik. Këto të fundit duhet t'i kryeni patjetër për shkak se rrezikoni që të shtoni peshë, duke bërë të pamundur kontrollin e tensionit. Së fundi këshillohet edhe shmangja e përdorimit të duhanit si dhe menaxhimi i stresit.

NIVELI

Në qoftë se tensioni juaj i gjakut është më poshtë se 120/80 mmHg, atëherë ju keni një presion normal të shëndetshëm të gjakut. Mbani këtë tension dhe kontrollojeni atë përsëri mbas një muaji. Në qoftë se tensioni juaj i gjakut është mbi 120/80 mmHg, por më pak se 140/90 mmHg, jeni në rrezik për t'u bërë hipertensivë. Prandaj ju duhet të merrni disa hapa të menjëhershme për të përmirësuar stilin e jetës suaj, dhe çdo vit duhet të kontrolloni presionin e gjakut te mjeku. Në qoftë se tensioni juaj i gjakut është rreth apo mbi 140/90 mmHg, ju duhet të takoni një person të kujdesit shëndetësor për të parë nëse keni tension të lartë të gjakut, apo nëse keni nevojë të



Tensioni

Nga kripa tek pesha trupore si ta kontrolloni

**KONTROLLI I TENSIONIT
TE GJAKUT**

- Reduktoni konsumimin e kripës, (5g kripë në ditë)
- Konsumoni një dietë të ekuilibruar dhe të shëndetshme bazuar në perime dhe fruta, drithëra, produkte ushqimore me pak yndyrë, peshk dhe bishtajore
- Shmangni përdorimin e dëmshëm të alkoolit
- Kryeni aktivitet fizik të rregullt 30 deri në 60 minuta disa ditë në javë
- Mbani një peshë trupore të shëndetshme
- Shmangni përdorimin e duhanit, si dhe vendet ku pihet duhani
- Menaxhoni stresin për të përmirësuar aftësitë dhe shëndetin tuaj



filloni trajtimin me mjekime për të parandaluar infarktin e zemrës dhe goditjen në tru

TË PREKURIT

Më shumë se një në tre të rritur në mbarë botën ka tension të lartë të gjakut, ose rreth 1.8 miliardë njerëz kanë hipertension. Gati 50% e këtyre njerëzve nuk janë në dijeni të gjendjes së tyre. Por edhe në ata të cilët janë të vetëdijshëm, gjysma e tyre nuk marrin ndonjë veprim për të kontrolluar presionin e gjakut, duke ndryshuar mënyrën e jetesës apo përdorimin e medikamenteve. Kjo do të thotë se 75% e popullsisë së botës që janë me hipertension janë në rrezik dhe janë kandidatë potencialë për sëmundje të zemrës, goditje në tru, sëmundje të veshkave ose vdekje të papritur. Përqindja e presionit të lartë të gjakut rritet me moshën, gjë që do të thotë se: Presioni i lartë i gjakut te njerëzit e moshë 20-30 vjeç takohet në masën 1 në 10. Presioni i lartë i gjakut te njerëzit e moshës 50 vjeç takohet në masën 5 në 10, ose një në dy njerëz. Komplikimet e presionit të lartë të gjakut llogariten më shumë se 9 milionë vdekje në mbarë botën çdo vit. Kjo përfshin 51% të vdekjeve për shkak të goditjes në tru dhe 45% të vdekjeve për shkak të sëmundjeve koronare të zemrës. Në vendin tonë hipertensionin takohet në 36% të grupmoshave 25 vjeç e sipër. Te burrat e grupmoshave 25 vjeç e sipër takohet në rreth 40% dhe te gratë e grupmoshave 25 vjeç e sipër në rreth 32%. Gjithashtu, 80% e femrave dhe 90% e meshkujve me hipertension nuk ishin të vetëdijshëm për gjendjen e tyre. Sipas vlerësimeve të OBSH-s, niveli i përgjithshëm i vdekshmërisë që i atribuohet tensionit të lartë të gjakut në Shqipëri ka patur një rritje domethënëse gjatë njëzet viteve të fundit, nga 27% që ishte në vitin 1990 ka shkuar në 35% në vitin 2010.

Hungaria deklaroi gjendjen e emergjencës të martën në dy qarqe pranë kufirit me Serbinë duke arrestuar një numër të madh refugjatësh që po përpiqen të hyjnë në vend nga Serbia. Lajmi erdhi pasi hyri në zbatim një legjislacion i ri më i fortë të martën, që lejon policinë të burgosë dhe ndjekë penalisht refugjatët që kalojnë kufirin e rrethuar me tela me gjemba në kufi me Serbinë dhe që hyjnë ilegalisht në vend. Policia hungareze të hënën në mbrëmje rrethoi një linjë hekurudhore mes Hungarisë dhe Serbisë, që ka qenë pika kryesore e kalimit të refugjatëve mes dy shteteve për dhjetëra mijëra refugjatë dhe migrantë që e kanë përdorur si një tranzit për udhëtimin drejt BE. Ndërkohë, një sasi e madhe refugjatësh janë mbledhur në anën serbe të kufirit pasi Hungaria e mbylli kalimin gjysmë ore pas mesnate. Policia hungareze arrestoi 16 refugjatë pasi ata prenë telat me gjemba dhe hynë ilegalisht në vend. Policët hungarezë janë të pranishëm në kufi, me kuaj, me mjete ushtarake dhe helikopterë. Imigracioni i paligjshëm në këtë vend do të dënohet deri në tre vjet burg. Kush refuzohet, kthehet në Serbi.

Nenad Ivanisheviç, një zyrtar i lartë në Ministrinë Serbe të Punës, tha se Serbia nuk do të pranojë kthimin e refugjatëve nga Hungaria. "Nëse

HUNGARIA
Policët hungarezë janë të pranishëm në kufi, me kuaj, me mjete ushtarake dhe helikopterë. Imigracioni i paligjshëm në këtë vend dënohet deri në tre vjet burg. Kush refuzohet, kthehet në Serbi



SERBIA
Hungarezët le t'i kthejnë refugjatët në Greqi, që është vendi i parë i BE ku kanë hyrë. Ne nuk do t'i pranojmë, edhe sikur të na duhet të çojmë ushtrinë në kufi," tha zyrtari serb Ivanisheviç

vjen nga jashtë Shengenit, por pasi kalon kontrollat fillestare në kufi, një individ nuk i nënshtrohet më procedurave të ngjashme sa herë që lëviz nga njëri vend Shengen në tjetrin. Gjithsesi, marrëveshja lejon një vend anëtarë të pezullojë lirinë e lëvizjes dhe të rivendosë kontrollin si pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme. Megjithatë, pezullimi i përkohshëm i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë.

NORVEGJIA

Politikanët norvegjezë kanë dalë me një ide të re për menaxhimin më të efektshëm të turmave të refugjatëve që po vërshojnë nga Lindja e Mesme. Ata mendojnë që të vendosin refugjatët në Svalbard, një arkipelag i braktisur në veri të Atlantikut ku jetojnë më shumë arinj polarë se sa njerëz. Politikanët norvegjezë kanë kontaktuar me guvernatorin e Svalbardit, prej të cilit kërkohet leja për zharkimin e refugjatëve në këtë vend, pasi Svalbard nuk është anëtar i zonës Shengen dhe nuk mund të pranojë njerëz si vendet e tjera.

Të 2.800 banorët e Svalbardit janë të angazhuar në punë në miniera, ndërsa kompania më e madhe në Svalbard "Store Norske" së fundmi ka njoftuar për shkurtimin e 150 vendeve të punës. Në muajin maj, një politikan norvegjez kishte propozuar që të dërgohen rreth 10.000 refugjatë në këtë arkipelag, por e kishte thënë vetëm për të demonstruar se sa pak hapësirë ka Norvegjia për të pritur valën e pamatë të tyre.

Hungaria i arreston të gjithë refugjatët në kufi

Mbipopullohet veriu i Serbisë, edhe qeveria turke vendos të bllokojë hyrjen e sirianëve

ata duan t'i kthejnë refugjatët, le t'i kthejnë në Greqi, që është vendi i parë i BE ku kanë hyrë. Ne nuk do t'i pranojmë, edhe sikur të na duhet të çojmë ushtrinë në kufi," tha Ivanisheviç. Serbia është një shtet tranzit për refugjatët në rrugën drejt BE-së. Më tepër se 130.000 refugjatë kanë kaluar përmes Serbisë që nga fillimi i vitit, tha ministri i Brendshëm Nebojsa Stefanović javën e shkuar.



SHENGENI

Vendimin për të rikthyer kontrollin në kufijtë e vendeve të Bashkimit Europian, po konsiderohet si një sfidë ndaj lëvizjes së lirë mes vendeve europiane. Kufizimet shkelin marrëveshjen e firmosur pranë Shengenit, një vend i vogël në Luksenburg, më 14 qershor të 1985-s. Çdo anëtar i hapësirës së lëvizjes së lirë duhet të aplikojë formalitetet hyrëse për këdo që

LAJME SHKURT



Papa: "E përdorin emrin tim për përfitime personale"

"Nuk kam patur ndonjëherë kaq shumë miq sa tani. Të gjithë duan të jenë miq të Papes, problemi është se ndihem i përdorur nga këta të ashtuquajtur "shokë" që u shfaqën kaq papritur". Kështu është shprehur Papa Françesku gjatë një interviste telefonike për radion argjentinasë "Milenium". Papa tregoi se njerëz që nuk i ka takuar veçse një apo dy herë në jetë, tani prezantohen si miq të ngushtë të tij. "E përdorin emrin tim për ndonjë përfitim personal, megjithatë është një përvojë të cilën mbase e kalojnë të gjithë. Miqësia është diçka e shenjtë. Bibla vetë thotë të kemi një apo e shumta dy miq", shtoi kreu i Vatikanit.

Kosovë, "për 15 vite me radhë do të realizojmë 20 mln euro investime"

"Jemi të obliguar të bëjmë në Kosovë një investim prej 20 milionë euro në 15 vite. Gjatë 2.5 viteve të kaluara kemi bërë një investim në vlerën e mbi 50 milionë eurove". Deklarata vjen nga Mesut Serhat Dinc, anëtar i Bordit Drejtues të Kompanisë së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Kosovës. Kjo kompani, në partneritet me Çalik dhe Limak kryejnë aktivitetet e shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë. Dinc tha për Anadolu Agency (AA) se këtë vit kanë arritur të shpërndajnë afërsisht 4,5 miliardë kë energji elektrike. A shtoi se Kosova është një vend i pasur veçanërisht me qymyr.

Ministri libanez: "Dy në 100 refugjatë janë xhihadistë"

Dy në çdo 100 emigrantë sirianë janë mbështetës dhe luftëtarë të shtetit islamik të ISIS-it. Ky ishte paralajmërimi i ministrit libanez të arsimit Elias Bousaab kundrejt kryeministrit britanik David Cameron, i cili vizitoi kampet e refugjatëve sirianë në Libi të hënën. "Xhihadistët janë duke u bërë një rrezik i madh jo vetëm për Europën, por për të gjithë vendet e tjera, pasi ata mund të rekrutojnë edhe fëmijë nga shkolla. Kjo situatë që po ndodh në Europë dhe botë është shumë e rrezikshme dhe duhet të shpërndajmë diçka për këtë", shtoi ministri libanez, Elias Bousaab.



Korea e Veriut kërcënon me armët nukleare: Gati sulmi në çdo kohë

Korea e Veriut është gati të përdorë në çdo kohë armët nukleare ndaj SHBA-së dhe aleatëve të saj, nëse Perëndimi nuk heq dorë nga politikat armiqësore ndaj regjimit të Kim Jong Un. Në deklaratën e publikuar nga media shtetërore e lajmeve, citohej një zyrtar i agjencisë atomike, i cili shtoi se Korea e Veriut po përmirëson arsenalin nuklear në sasi dhe cilësi. Kjo nuk është hera e parë që Korea e Veriut kërcënon Perëndimin me sulme nukleare por dyshimet mbeten ende të forta nëse shteti komunist ka realizat kapacitetet dhe teknologjinë për të goditur me armë nukleare.

Putin mbështet Sirinë, kërkon ndihmë për Assad-in



Presidenti rus Vladimir Putin, u zotua të vazhdojë mbështetjen ushtarake për Damaskun, pavarësisht shqetësimeve mbi rolin e vendit të tij në luftën civile të Sirisë. Putin i nxiti dhe shtetet e tjera t'i bashkohen Moskës në nismën e saj për të dërguar atje asistencë ushtarake dhe teknike. Më herët, Zëdhënësi i Pentagonit, Jeff Davis deklaroi se ka të dhëna që ditët e fundit Rusia ka zhvendosur trupa dhe pajisje në një zonë pranë Latakias, ku ndodhet një bazë ajrore. Qytet-port në brigjet e vendit, është nën kontrollin e forcave të Presidentit Bashar al Assad, aleat i ngushtë i Moskës.

Greqi, Tsipras: Fitoj zgjedhjet, jo koalicion me demokratët

E ndërsa Greqia po përgatitet sërish për zgjedhjet e përgjithshme dy kandidatët kryesorë për kryeministër, janë përballuar në debatin e dytë televiziv. Lideri i Syrizes, Aleksis Tsipras dhe lideri i Demokracisë së Re, Evanhelos Meimarakis u fokusuan kryesisht në diskutimin për ekonominë dhe

emigracionin. Tsipras është shfaqur i sigurt për një shumicë absolute të partisë së tij në zgjedhjet e së dielës, ndërsa Meimarakis, duke mos e pranuar një rezultat të tillë, ka hedhur idenë e një koalicioni të madh pas zgjedhjeve. Por, Tsipras e ka kundërshtuar këtë skenar duke e cilësuar si jo natyral.

ADMIRINA PEÇI
TIRANE

Dy dokumentet që sjellim sot kanë një rëndësi të veçantë sa i takon fillësavetë organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Informativ Shqiptar në fund të Luftës. Njëri prej tyre është letra e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm Spiro Moisiu e datës 19 prill 1944 ku kërkohen informata të rëndësishme e të shpejta nga shtabi i batalionit "Hakmarrje" mbi vendosjen e forcave armike, emrat e disa fshatrave balliste dhe elementëve të Ballit në rrethet e Kolonjës e Leskovikut, si dhe lëvizjet e forcave armike në segmentin Leskovik-Korçë. Dokumenti tjetër është një qarkore e firmosur po prej Moisiut me 9 nëntor 1944, dërguar qarkëve: Berat, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, ku kërkohet të hartohen listat emërore për elementët armiq e bashkëpunëtorë me pushtuesit të këtyre qarkëve, pavarësisht se ku janë dhe ç'pozicion mbanin në momentin që po shpërndaheshin kjo qarkore. "Porositeni me formue lista emnore të të gjithë reaksionarve të qarkut t'uej", shkruan Moisiu. Në këto lista sipas gjeneral Moisiut duhej të përfshiheshin "të gjithë ata që i kanë shërbye dy okupatorve qoftë si nëpunës zyrtarë të shtetit, qoftë me anë të organizatave trathtare reaksionare". Moisiu porositi që "për secilin të hetohet dhe të bahet një përshkrim i aktivitetit të tij politik kriminel dhe të shënohet gjendja e tij e sotme: i rreshtuem, i inkuadruem tashti vonë apo i aratisur dhe ku." Ndryshe nga dokumenti i parë, qarkorja e 9 nëntorit 1944, qartëson përfundimisht rolin që do të kishte Sigurimi i shtetit më vonë, që në këtë qarkore cilësohet si "organet t'ona të sigurimit popullor."

Më poshtë sjellim të plotë të dy këto dokumente.

DOKUMENTI 1

Shtabi i Përgjith. U.P.V.N.Ç.
Shqiptare
Zonë e lirë 19.4.44
Shtabit Bat. Hakmarrje
E për njoftim
Shtabit të Qarkut Korçës
Landa: Organizim i shërbimit informasjoni.


Na intereson të dimë:
I) Vendosjen e forcave armike (gjermane) në Leskovik e Kolonjë, vendosjen e forcave armike gjat rrugës Leskovik-Korçë, sasinë e këtyre forcave, vëndet ku janë vendosur fortifikatat mbrojtëse, lloin e armatimit që kanë, gjendjen morale të trupave, mënyrën e furnizimit të këtyre trupave, a çkëmbehen dëndur këto trupa apo qendrojnë po ato, a bëjnë shërbim patrulle natën apo rinë të mbyllur në fortifikata.

II) Emërat e fshatrave balliste në rrethet e Kolonjës e të Leskovikut, emërat e personave ballista të këtyre fshatrave që janë aratisur dhe që drejtojnë çetat trathetare, forcat e armatosura të Ballit në rrethet e Kolonjës e të Leskovikut, vëndi i depovet të tyre.

III) Lëvizjet e armikut në rugin Leskovik-Korçë, sasia e maqinave të çdo kollone, drejtimi i kollonës (prej Leskoviku në Korçë apo prej Korçe në Leskovik), mundësiat lloj i sendeve ose i ushtarve që transportohen.

Për të patur këto informata, të cilat ju duhet t'na i transmetoni direkt dhe regullisht me shpejtësin më të madhe në Staravekë, ju duhet të organizoni një shërbim informasjoni me anë të fshatarve dhe me partizanë direkt.

Të dërgoni të mirni dy arka me mina të cilat do t'i hidhni herë pas here në rugin



FILLESAT E SIGURIMIT

SPIRO MOISIU: HARTONI LISTAT E ELEMENTEVE ARMIQ, HETONI KU JANE

Dy dokumente për organizimin e shërbimit informativ. Qarkorjae 9 nëntorit 1944 hetimet me objektivitet, siç duhet ti karakterizojë organet tona të Sigurimit



Spiro Moisiu

automobilistike që kalojnë kollona. Këto mina kanë efekt sa për të prishur rotën e një maqine. Partizanët që do të vinë t'i marin të kërkojnë instruksione në Staravekë për përdorimin e tyre. Në raportet që do të drejtoni shtabit Qarkut duhet t'i tregoni edhe efektet e këtyre minave.

Vdekje fashizmit – Liri Popullit
Për Shtabin e Përgjithshëm
Komandant i Shtabit
(Spiro Moisiu)
Komisar i Shtabit Përgjith.
(Enver Hoxha)

DOKUMENTI 2

KOMANDA E PËRGJITHSHME E
USHTRIS NACIONAL-ÇLIRIMTARE
Nr. 012 Rez.
Seksioni I
Berat, 9/XI/944
Komandave të Qarkut

BERAT
VLORË
GJIROKASTËR
KORÇË

Çlirimi i plotë i Shqipërisë së Jugut ka zgjerue fushën e veprimit të organeve t'ona të sigurimit popullor, tue imponue kështu marrjen e disa masave të reja me karakter të gjerë kundra elementave antipopullor që kanë shërbye deri dje armikun okupator.
Marrja e këtyre masave asht imponue edhe

pse një pjesë e reaksionarve, tuj përfutue prej vijës së drejtë dhe të shëndoshë të frontit, të lënë të lirë, kanë fillue në disa vende (fatlumsisht deri tani të kufizuem) me përhap fsheshurazi, me metodën e tyre të fëlliqur që çuan kolonën e V-te, parulla përçmuese për lëvizjen t'onë me qëllim diskreditimi.

Me qëllim që të uniformizojmë veprimin e gjithë Komandave Qarku dhe që të dimë se ku të përqendrohet më tepër syri jonë vëzhgonjës, porositeni me formue lista emnore të të gjithë reaksionarve të qarkut t'uej. Këto lista të përfshijnë jo vetëm ata reaksionare që gjinden sot të lirë në qarkun t'uej, po gjithashtu ata që janë t'arestuem, të ikur ose që janë hedhur në rreshtat t'ona tashti vonë, me një fjalë të gjithë ata që i kanë shërbye dy okupatorve qoftë si nëpunës zyrtarë të shtetit, qoftë me anë të organizatave trathtare reaksionare.

Për secilin të hetohet dhe të bahet një përshkrim i aktivitetit të tij politik kriminel dhe të shënohet gjendja e tij e sotme: i rreshtuem, i inkuadruem tashti vonë apo i aratisur dhe ku.

Përpilimit të këtyre listave t'i jepet një karakter urëgjent dhe hetimet të vahen me objektivitetin që duhet të çqatj organet t'ona të sigurimit popullor. Mbas t'na i dërgoni, do t'ju njoftojmë se ç'duhet bërë për secilin.


Vdekje Fashizmit – Liri Popullit
Kryetar i Shtabit Madhor
(Gjeneral-Major Spiro Moisiu)



Piktura "Çifti lab"



Skulptura "Ngulja", bronz



Piktura "Nudo e mbështetur"

Ekspozita retrospektive, e hapur deri më 4 tetor 2015

Maks Velo: Pikturat nuk i kam zbërthyer dot as vetë

Rikthimi i veprave të djegura në kohën e diktaturës në Galerinë Kombëtare të Arteve

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Duke u shfaqur edhe më i plotë, me vepra që të befason kur thotë se "nuk i kam zbërthyer dot as vetë", Maks Velo përfundimisht është rikthyer. Nuk është ky thjesht një rikthim në Galerinë Kombëtare të Arteve, ku e përzgjedhën për të çelur sezonin artistik, por është një rikthim tek shenjat e tjera piktorike që rrinin ende të fshehura brenda tij. Maks Velo i zbulon të gjitha. Tani e pamë të shfaqet me profilin e plotë të një artisti postmodern, duke bashkuar ëndrrat e ndara në kohë nga njëra tjetra me një fill abstrakt si vetë liria e tij. "Ky album është rrugëtimi im i jetës", -thotë piktori. Po ta vësh se si shprehet, ai e ka përmbytur idiomën klishe "i jetës sime", ku duket se Maks Velos i përket vetëm rrugëtimi, e jeta mbetet si një lloj përjetësie. "Është autobiografia ime me njolla, me vija, figura të kuptueshme dhe të pakuptueshme. E nuk i kam zbërthyer dot as vetë. Dhe kjo më kënaqte, misteri im i brendshëm i nxjerrë jashtë, në saj të artit". Ja ai rebeli "që merr flakë" në intervista, tani shfaqet me gjithë brishtësinë e tij prej artisti, tejtej i lirë siç do të guxonte veç në ëndrra. Në fakt, po të vësh ekspozitën, krijimtaria e tij nuk është e tjetërllotë nga ëndrra. "Bardhësia e letrës është mirësia njerëzore. Letra është çarçafi, ku u projektuan gjithë ëndrrat e njerëzimit dhe ëndrrat e mia. Burgu im është projektuar në letër", thotë piktori. Maks Velo kishte nisur rrugëtimin në vitet '60 si artist dhe arkitekt i talentuar, por rruga e tij u ndërpre kur u dënua me dhjetë vjet burg.

Ai e kujton kohën kur nisi persekutimi i tij si artist, në vitet '70, ku u kritikua për tendencat moderniste bashkë me shumë artistë të tjerë. Në vitin 1968, Maks Velo arrestohet dhe burgoset, duke ia hequr gjithë lirinë e të ëndërruarit artistikisht.

Por megjithatë nuk mundi të ikte nga liria. "Cikli me vizatimet abstrakte (Lavi) që fillova më 1964-ën është ai që më dha dimensionin e lirisë. Nëse arti ta dhuron lirinë, diktatura nuk ta merr dot. Sado që diktatura dogji qindra vepra të miat, u ngrita prapë të punoj. Ky album është dëshmitar. Qëllimin që ia vura vetes e realizova, do të lë një shenjë", thotë piktori

nga njëra vepër, pastaj nga tjetra, por e pamundur t'u përgjigjesh gjithë këtyre shenjave me gjuhën e tyre. Ç'mistere delikate fshehin vallë këto piktura, pyet veten kur ekspozitën ke nisur ta shohësh sërish nga fillimi. Meditim para një veprë të djegur, e shpëtuar nga periudha komuniste, "Dy muzikantë" 1969, imazhi i së cilës ka mbijetuar në një foto ku ka

se do të ma rëmbente njeri. Isha i lumtur si vija firmën. Por ajo lumturi ishte e dënueshme. Diktatura nuk lejonte të gëzoheshe me veprën tënde", thotë Maks Velo. Tek kjo ekspozitë mbresëlënëse, një pjesë e veprave të tij janë të lidhura me punën e detyruar në minierat e kromit në Spaç, të shkëputura nga koleksioni i pikturave me bojë kine. Por aty gjen edhe një numër i pikturave në vaj dhe akrilik, që paraqesin figura nga kampi i burgut, por dhe piktura me tema të jetës e në të gjitha teknikat, me tituj të tillë si "Simbole muzikore", "Kënga labe", "Portret ciganeje", "Marrëdhënie", "Disku", "Qenia dhe trau", por edhe nudot femërore, etj. Të duket sikur gjithë rruzulli tokësor është në pëllëmbën e piktorit Maks Velo. "Maks Velo duket sikur pikturon me syrin e tretë, prandaj arin të padukshmen. Atë që është brenda ta bëjë të dukshme për ne", shprehet shkrimtari i njohur Zija Çela pas çeljes së kësaj ekspozite, duke vijuar ta komentojë krijimtarinë e piktorit me këto fjalë: "Piktura e tij nuk tregon si dukemi, por çfarë jemi. Prandaj ta nxit mendimin. Piktura e tij përveç se shenjë e artit, është shenjë e lirisë. Disa liria i ka çuar tek arti, ndërsa Maks Velon është arti që e ka çuar tek liria". Në ekspozitën e Maks Velos nuk mungojnë dhe skulpturat prej bronz, që kërkojnë të kesh një marrëdhënie të fortë perceptimi me to, për t'i interpretuar si duhet.

Padyshim që piktura e Maks Velos është një sensacion që vjen me një gjuhë unike të stilit, bashkuar me kodet e fshehta të imagjinatës njerëzore. Piktura e Maks Velos shfaqet me shenja që lënë shenjë edhe në historinë e artit shqiptar.



Piktura e djegur, "Dy muzikantë" 1969, imazhi i së cilës ka mbijetuar në një foto ku ka dalë edhe Maks Velo vetë

Maks Velo. Ekspozita retrospektive e Maks Velos u çel më 4 shtator e do të qëndrojë e hapur deri më 4 tetor 2015. Duhet ditë me radhë të ndjekësh të gjitha shenjat piktorike që pozojnë "gojëkyçur" e të "përpëjnë me sy". Ja kështu intrigohej e kësaj ekspozite nuk i del fundi duke e vizatuar. Rikthehesh e sheh, e përjeton, entuziazmohesh njëherë

dalë edhe Maks Velo vetë. Piktori i ri në atë kohë, shfaqet me një vështrim që nuk mund të mos i thuasht parashikues për kohën e këqija. Diçka zhbiron me trishtim në horizontet e stuhisë diktatoriale që po afrohej. Pas tij është vepra, shenja që ai ka lënë edhe si shenjë të vijueshmërisë së stilit. "Sa herë përfundoj veprën, doja të vija firmën, sikur kisha frikë

Muzikë klasike

Ermonela Jaho, 10 ditë shfaqje në Operën e Parisit



Deri më 12 tetor 2015, artistja shqiptare me famë botërore Ermonela Jaho do të këndojë Violetën e "Madama Butterfly" në operën e Parisit. Duke nisur që nga dita e parë e premierës, që u dha në 8 shtator, Ermonela Jaho do të këndojë në 10 shfaqje. Sopranoja Jaho do të jetë deri më 12 tetor në Paris. Shfaqjet e saj do të jenë në datat 27, 30 shtator, 3, 7, 10, 13 tetor 2015. Më pas Jaho do të këndojë edhe Anna Bolenën në Moskë. Do të bëjë sërish një rikthim në Paris dhe, në Dhjetor, një tjetër lajm i rëndësishëm vjen nga artistja. Në "Operastadt" të Vjenës, një ndër teatrot më të mirë në botë, do të jenë tre artistët shqiptarë, që do të ngjiten në skenën e saj. Sërish me "Traviatën", Ermonela Jaho dhe Saimir Pirgu, në rolet e Violetës dhe Alfredo; dhe në atë të Giuseppe, Dritan Luca.

Ekspozita

Ardian Isufi, përball publikun me maskën e diktatorit

Piktori Ardian Isufi, do çelë më 16 shtator, ekspozitën "ANTHOMAZH", ekspozitë e cila vjen në formën e një instalacioni artistik duke sjellë një sintezë mes elementeve historikë dhe atyre të artit pamor. Artisti ka shfrytëzuar faktin që Arkiva e Muzeut Historik Kombëtar ka në përbërjen e saj "Maskën e vdekjes" së diktatorit Enver Hoxha, si një artefakt shumë interesant për t'u shfaqur për herë të parë për publikun. Në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar, artisti Isufi do të prezantohet për publikun me një qasje të re konceptuale të marrëdhënies që do të ketë çdo individ duke u përballur me diktatorin (maskën e tij) dhe me historinë e diktaturës. Ekspozita "ANTHOMAZH" do të çelë më 16 shtator në orën 19.00, në Hollin kryesor të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë.

Izaura Ndoj
TIRANE

SkaNdal", dokumentari i cili tregon hapur historinë e lëvizjes LGBT në Shqipëri gjatë pesë viteve të fundit do të vij në Kinema Milenium. Historinë e disa djemve dhe vajzave, jo më me fytyrë dhe emra të fshehur dhe mënyrën si lëvizja LGBT ndryshoi jetën e tyre do të jetëshohet në 63 minuta. Në një intervistë për "Shqiptarja.Com", drejtoresha Ekzekutive e Aleancës kundër Diskriminimit LGBT, na tregon se si dokumentari me regji të Elton Baxhakut dhe Eriona Camit dhe skenar të dy aktivistëve të komunitetit në Shqipëri, rrëfihen idetë fillestare, frikërat, aksionet e para si ngjitja e posterave në rrugë apo lyerja e stolave me ngjyrat e yllberit, e më pas rritja dhe zhvillimi i lëvizjes në evente më të mëdha. Por, ajo në këtë rrëfim ndalet edhe tek ndryshimet e kërkuara në Kodin e Familjes, të cilat sipas saj edhe pse janë përkrahur nga kreu i Parlamentit, Ilir Meta, janë bllokuar në Ministrinë e Drejtësisë. Sipas Xheni Karajit, kjo situatë është si puna e lojës së ping-pongut, ku secila palë përpiqet t'ia ngeci topin tjetrës. Dokumentari do të shfaqet për publikun e gjerë në 'Kinema Millenium' në datat 22-25 Shtator, në orën 19:00 dhe 26 Shtator, në orën 17:00.

"SkaNdal", dokumentari që rrëfen historinë e lëvizjes LGBT në Shqipëri...?

"SkaNdal" është dokumentari i parë që tregon historinë e komunitetit LGBT duke nisur nga viti 1994 kur homoseksualiteti u dekriminalizua në Shqipëri. Për herë të parë persona nga komuniteti LGBT flasin hapur rreth jetës së tyre, sfidave që kanë hasur me familjet dhe ambientin përreth, faktin se si përfshirja në aktivizim ka ndryshuar jetën e tyre dhe të një komuniteti të tërë. Në 63 minuta përshkruhen 5 vjet historia. Historia e disa aktivistëve të rinj që zhbuluan një lëvizje të tërë vetëm nëpërmjet disa festave në mbrëmje dhe socializimit në internet. Tregohen idetë fillestare, frikërat, aksionet e para si ngjitja e posterave në rrugë apo lyerja e stolave me ngjyrat e yllberit, e më pas rritja dhe zhvillimi i lëvizjes në evente më të mëdha. "SkaNdal" tregon si ngjytrat mund t'i ndryshojnë njerëzit. Tregon si këta njerëz arritën jo vetëm të shfaqin idetë e tyre në media, por të fuqizojnë një shoqëri të tërë nëpërmjet saj, duke fituar kështu betejën e vështirë me mediat e shekullit të 21-të.

Si qëndrojnë statistikave të viktimave të dhunës për shkak të orientimit seksual gjatë këtyre pesë viteve. Është rritur?

Përsa i përket dhunës, dy ambientet ku haset më shumë dhunë nga komuniteti LGBT janë familja dhe shkolla. Në momentin që persona të komunitetit bëjnë 'coming out' në familje, përballen me dhu-



Perfaqesues të komunitetit LGBT duke parakaluar në bulevardin Deshmoret e Kombit

Xheni Karaj: "SkaNdal", rrëfen historinë e LGBT-së në Shqipëri

Ndryshimet në Kodin e Familjes, bllokohet në ministri

"Pobëjnë lojën e ping-pongut, ku secila palë përpiqet t'ia ngeci topin tjetrës. Duam flamurin e paqes së fetarëve"

në psikologjike dhe fizike dhe në raste ekstreme përzihen dhe nga shtëpia. Vetëm gjatë këtij viti pranë. Strehës LGBT janë strehuar 8 të rinj të cilët ishin abuzuar fizikisht dhe përzënë nga familjet e tyre. Njëri prej tyre mbahej i mbyllur në shtëpi me qëllim që ta kuronin. U detyruan të kontaktonim policinë për të ndërhyrë dhe më pas e strehuam në strehë. Ndërkohë që në shkolla diskriminimi ndodh jo vetëm nga bashkëmoshatarët, por dhe nga mësuesit dhe psikologët e shkollave të cilët e trajtojnë homoseksualitetin si sëmundje. Rastet e dhunës nuk raportohen në institucione për shkak të mungesës së besimit që këto institucione do të ndërmarrin masa.

Mendoni se janë thyer tabut edhe në Shqipëri apo kemi akoma shumë punë për të qenë transparent?

Vitet e fundit gjërat kanë filluar të ndryshojnë, kjo falë mobili-

zimit të vetë komunitetit LGBT, mbështetjes së personave publik që i janë bashkuar kauzës LGBT, mediave dhe hapjes së dialogut me qeverinë e mëparshme dhe atë përkatëse. Gjithsesi mbetet akoma shumë për të bërë përsa i përket ndërgjegjësimi publik dhe ndryshimit të stereotipeve. Akoma homoseksualiteti vazhdon të perceptohet gjerësisht si një sëmundje. Këto fushata nuk mund të bëhen vetëm nga organizatat LGBT, por duhet të jenë pjesë e politikave antidiskriminuese shtetërore. Gjithashtu mungojnë figurat politike që ngrenë hapur çështjet LGBT. Një pjesë e tyre këto çështje i adresojnë në tryeza të rrumbullakta mes të huajve, por kompleksohen kur bëhet fjalë për të folur rreth LGBT në televizionet tona. Pra, ka akoma shumë punë për të qenë transparent dhe europian. Nuk na bën qeveri europiane vetëm aprovimi



i ligjeve, por implementimi i tyre.

Keni kërkuar që të mbani flamurin e takimit të paqes, për çfarë do ta përdorni?

Para se të shihja flamurin e paqes, kisha parë nëpër Tiranë përfaqësues të feve të ndryshme veshur me petkët e tyre fetare. Më bëri përshtypje pozitive ky fakt dhe po mendoja sa harmonike dhe estetike bukuri duket gjithëkrah përreth kur ka diversitet. Më vonë mora vesh për takimin e paqes dhe pashë platformën e ndërtuar te Piramida. Dukej mrekullisht bukur. Çuditërisht produkt i kombinimit të bashkëjetesës mos të përcajtohet si bashkim i një mashkulli dhe një femre, gjë që përjashton çiftet LGBT, por si bashkim mes dy njerëzish.

A po planifikoni një paradë madhështore vitin e ardhshëm?

Po planifikojmë një paradë me mesazhe politike të fuqishme. Detajet do t'i japim më vonë.

Çfarë ndryshimesh ligjore do të kërkontë për të lejuar martesat?

Ndryshimet në Kodin e Familjes janë bërë dhe prezantuar dy vite më parë. Këto ndryshime konsistojnë në ndryshimin e nenit të bashkëjetesës, ku ndryshimi i përkufizimit të bashkëjetesës ka ndryshuar. Pra, propozimi është që bashkëjetesa mos të përcajtohet si bashkim i një mashkulli dhe një femre, gjë që përjashton çiftet LGBT, por si bashkim mes dy njerëzish.

A keni diskutuar me Ministrinë e Mirëqenies Sociale për ndryshimin në Kodin e Familjes?

Kodi i Familjes me ndryshimet përkatëse i është dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë e cila nuk po ndërmerr asnjë hap për ta prezantuar në Parlament edhe pse na u premtua që këto ndryshime do të paraqiteshin në Parlament vitin e shkuar. Unë nuk e di çfarë ka ndodhur dhe pse është bllokuar ky proces edhe pse është me Kristin kemi takuar dhe Kryetarin e Parlamentit Ilir Metën dhe e kemi ngritur si problem. Por, mund të them që mosmarrëveshtja e këtij premtimi tregon mungesë serioziteti nga ana e shtetit shqiptar, karshi qytetarëve të tij që duhet t'i trajtojë si të barabartë. Pra, çiftet LGBT shihen si qytetar të dorës së dytë në Kodin e Familjes dhe marrëdhëniet e tyre janë totalisht të panjohura dhe të pambrujtura nga ligji.

Po me Ministrin Naço keni diskutuar për këtë bllokim, po me Kryeministrin Rama?

Folëm me kreun e Parlamentit, Metën. Tani do të kërkojmë takim dhe me Ministrin Naçon pasi nuk jep shpjegime.

Çfarë ju premtoi kreu i Parlamentit?

Që do të na siguronte një takim me ministrin Naço dhe që është kundër diskriminimit. Kjo situatë është si puna e lojës së ping-pongut, ku secila palë përpiqet t'ia ngeci topin tjetrës.

Ngjallet Juventus fiton në Angli, Real e PSG "OK"

Anglezët turpërohen në Europë. Barcelona fillon sot mbrojtjen e trofeut nga Roma

DYLBER BALLA
TIRANE

Juventusit që nuk ka provuar ende shijen e fitores në Serie A, ka arritur një fitore të madhe 2-1 në Angli ndaj Manchester City. Edhe pse italianët u gjendën në dizavantazh me një autogol të Kielinit, në fillim të pjesës së dytë, arritën të shënonin dy gola me Manxhukic e Morata, duke marrë një fitore të madhe Real Madrid ka mundur pa ndonjë problem 4-0 Shakhtar me tre gola të C.Ronaldo, ndërsa Man. Utd ka zhgënjyer duke u mundur 1-2 nga PSV. Sonte do të zhvillohen ndeshjet e katër grupeve të natës së dytë të Champions League. Ndeshja kryesore është Roma-Barcelona. Dy ekipet janë në formë shumë të mirë në kampionatet respektive duke premtuar një përplasje të fortë. Barcelona nis edicionin e ri me fronin e kampiones në fuqi të Europës dhe favorite për ta fituar sërish këtë edicion. Në fushë për Romën në ndeshjen



e sotme pritet që të mungojë sërish, ashtu si në kampionat legjenda Totti. Francezi Garcia duket se këtë edicion nuk do t'i besojë shumë minuta italianit, pasi vitet kanë bërë të tyre. Shpresa e italianëve për të mposhtur Barcelonën në ndeshjen e parë është të bosh-

njakët Pjanic përmes goditjeve standarde dhe Dzekos. Dy lojtarët kanë qenë vendimtarë në ndeshjet e para në kampionat dhe pritet që të mbajnë peshën kryesore të verdhekuqit. Ndërsa Barcelona do të mbështetet të Suarez dhe Mes-Neymar. Sonte do të zbrësë në

CHAMPIONS	
SOT	
GRUPI A	
■	PSG - Malmoe 2-0
■	Real M. - Donetsk 4-0
GRUPI B	
■	PSV - Manch. United 2-1
■	Volfsburg - CSKA 1-0
GRUPI C	
■	Benfica - Astana 2-0
■	Galatasaray - Atletico 0-2
GRUPI D	
■	Manc. City-Juventus 1-2
■	Sevilla-Borussia M. 3-0
NESËR	
GRUPI E	
■	20:45 Leverkusen - BATE
■	20:45 Roma - Barcelona
GRUPI F	
■	20:45 Dinamo - Arsenal
■	20:45 Olympiakos - Bayern
GRUPI G	
■	20:45 Chelsea - Maccabi
■	20:45 Dynamo Kyiv-Porto
GRUPI H	
■	20:45 Gent - Lyon
■	20:45 Valencia - Zenit

fushë edhe Çelësi i Murinjos që ndodhet përpara një tjetër sfide kyce, pasi nëse humbet në kampionat do të pasohen me një tjetër në Champions League pozicioni i portugezitetit të blutë do të vendoset seriozisht në diskutim dhe mund të shkarkohej nga Abramovic.

BILETAT

Serbia, fluksi bllokton shitjen online, monitorim nga SHISH

Sistemi online në Federatën Shqiptare të Futbollit duket se nuk do ta ketë të "lehtë" që të përzgjedhë tifozët me fat për një biletë për të parë ndeshjen e kthimit me Serbinë në Elbasan. Pas njëritimit për daljen e biletave online dhe kërkesave të shumta, nga fluksi i lartë mësohet se është bllokuar sistemi. Megjithatë pohimi i faktit që gjithçka do të minitorohet edhe nga SHISH le të kuptosh se edhe pajisja me bileta nuk do të jetë rastësore. Biletat variojnë nga 1 mijë lektë të reja në 10 mijë për të parë ndeshjen me Serbinë më 8 tetor në Elbasan.

DËNIMI

Disiplina godet dhunën, Malota e Hila dënohen me 5 ndeshje

Komisioni i Disiplinës pranë FSHF-së nuk ka toleruar aspak fenomenet e dhunës në ndeshjet e Kategorisë Superiore. Kështu disiplina dënoi dje me pezullim prej 5 ndeshjes lojtarin e Kukësit, Renato Mallota, për goditje me shkelm ndaj lojtarit kundërshtar dhe po kaq edhe lojtarin e Teutës, Ardit Hila, për goditje me kokë ndaj lojtarit kundërshtar. Dënimi edhe më të rëndë me 8 ndeshje ka marrë zyrtari i KF "Vllaznia", Ilir Dibra, për hyrje në fushën e lojës pa lejen e gjyqtarit dhe sjellje jo sportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes.

SHQIPËRI-SERBI / PARANDALOHET "HAKMARRJA SERBE"?

Një serb kapet me dy dronë në Qafë-Thanë

Një shtetas serb është ndaluar nga policia në Qafë-Thanë, në pikën kufitare të vendit tone me Maqedoninë, pasi në automjetin me të cilin udhëtonte iu gjetën dy dronë. Duke qenë se pas një muaji do të luhet ndeshja e futbollit midis Shqipërisë e Serbisë, prania e dy dronëve në automjetin e shtetasit serb ka alarmuar policinë kufitare, e cila u lajmërua nga doganierët që kryen kontrollin. Pronari i makinës po udhëtonte bashkë me dy shtetas të tjerë serbë. Kreu i Doganës së Qafë-Thanës, Olsi Ikonimi bën me dije se: "Shtetasit serb vinte nga Maqedonia për në Shqipëri dhe ka deklaruar vetë se kishte dy dronë në makinë. Ai ka bërë të ditur se dronët po i transportonte me porosi të një kompanie shqiptare me qendër në Tiranë. Zhdoganimi i mjeteve të vogla fluturuese do të bëhet në doganën e Tiranës". Pavarësisht anës zyrtare dyshimi mbetet pasi duket si një rastësi e çuditshme që disa serbë transportojnë dy dronë para ndeshjes së dy kombëtareve. Më 8 tetor, në "Elbasan Arena" do të luhet ndeshja Shqipëri-Serbi dhe dyshohet se droni mund të përdoret për "hakmarrje" për atë që ndodhi në Beograd më 14 tetor 2014, ku Ballist Morina ngrii një dron me flamurin "Autochtonus".

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Denoncimet/ Gjejnë të dashur më të vegjël, gratë bien pre e dhunës
- Mirditori i kërkuar për vrasje qëllon RENEJA-n, fshihet në pyll
- Ja çfarë bën partneri juaj kur është vetëm, s'keni as idenë më të vogël
- Rama: Nesër prova kuptimplota se kush e lejoj trafikun e drogës
- Protestë para ekspozitës së Ramës në Mynih: Braktiseni siç bëri me ne
- Bleona Qereti rikthehet në Shqipëri në rolin e gjykatëses, këtë herë në...
- Kodi i ri, kush nuk gëzon statusin e nëpunësit nuk rikthehet dot në punë
- Baner provokues për Serbinë në Elbasan Arena, tifozët dalin kundër
- Itali, trafik kokaine fshehur në pako NIKE, arrestohet shqiptari
- Kallëzimi: Komshiu më erdihi 3 herë në shtëpi, tentoi të më përdhunonte

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Rama: Nesër prova kuptimplota se kush e lejoj trafikun e drogës
- FOTOLAJM/ Mësuesja nga Elbasani: Ufffffaaaaa filloi shkolla
- Ulet TVSH e turizmit nga 20 në 8 %, PS rrezon dekretrin e Presidentit
- Sali Berisha 50 minuta kokë më kokë me Presidentin Nishani
- "Festa e Miqësisë" nga birra Elbar 10 ditë dedikuar miqësisë së vërtetë

VIDEOET MË TË KLIKUARA DJE

Shkodër, Klosi: Hoqëm nga rruga 200 fëmijë, i çojmë sot në shkollë

Pushohet i gjithë stafi një ditë para shkollës, mësuesit dalin në protestë

Lezhë, rritet numri i të punësuarëve në 6-mujorin e dytë të këtij viti

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

Sipas eksperiences suaj personale, kuponi tatimor ju eshte dhene:

Rezultati i Sondazhit

Gjithmone	18.69%
Disa here	48.26%
Kurre	33.05%

SHËNIM:
Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë.

954 | 209.770

KOMENTET E DJESHME | **TOTALI LIKE**

FJALËKRYQESH

NGA Kadri VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 33 KUTI

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë kloçkë. -Është zot i tokës.
2. Nuk i tradhtojnë principet. -Ndoshta është ndryshe.
3. Mund të bëhet risotto. -Iniciale e Einstein.
...
12. Mund të jenë çiklistikë -Është edhe ai kampion.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Completed crossword grid with words filled in.

VERTIKAL

- 1. U verteua nga Askushi. -Iniciale e Raveli.
2. Janë klasat që nuk takohen. -Pak derdimene.
3. Një kafshë që hap galeri. -Është këndi më shumë se 90 gradë.
...
13. Mbarojnë një takim.

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 crossword grid with numbers 1-17 in the first column.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Completed crossword grid for the sports crossword.

HORIZONTAL

- 1. Felipe pilot.
2. Tipi për jo ti.
6. Entë Prodhues Lokale
9. Me noble të tregon boksist.
...
26. Schweinsteiger te

- Manchester Ltd.
27. Italia në Internet.
28. Entë Operative Juridike.
30. Diftong teatral.
31. Iniciale të Lavani-t.
32. Flanders e Defoe.
36. Janë në qendër
37. Personazhi në foto.
43. Personazhi në foto.

VERTIKAL

- 1. Është një vendëshe në Grand Prix.
2. Është lloj papagalli.
3. Të parat në stafete.
4. Një dies... liturgjike.
5. Gara... di Siena.
6. Në krye të eksitremistëve.
7. Ndahet në barazim.
8. Mbreti i Shakespeare.
10. Hunt aktore
11. E para për... lady
13. Tregohet me një shifer.
14. Halli i sulmit shkodran dikur.
15. Gaka tek Cibona.
17. Samprap ish-tenist
18. Pikët e fitores.
19. Gabim rrjete në tenis.
20. Hapin një rubrikë.
21. Institute nëkomëtare Ekonomike.
23. Në fund të ndeshjes.
26. Borg ish-kampion i tenisit.
29. Sivori ish-as argentinas.
31. Mund të jenë autonome të tilla.
33. Janë tek në lecka.
34. Chaney që qe aktor.
35. Gjysmë erotik
36. Pak atraktuarë.
37. Fillonjë melodinë.
38. Kufizonjë një vend
39. Diftong në teori.
40. Kufizonjë një repart.
41. Mbyllin një sirtar.
42. Fise pa fe

SUDOKU

PLOTESONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

PËRGJIGJE

Completed 9x9 Sudoku grid.

Another 9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI: Shfrytëzohen si me shume qe te mundeni sot kohën kur te jeni pranë partnerit. Filsi me te për çdo gjë qe ju shfrytëson, por edhe për gjërat qe ju bëjnë te ndiheni mire. Beqaret nuk do kenë aspak fat dhe do mbeten përsëri vetëm. Ne planin financiar nuk duhet të bëni çmenduri sepse po filluar problemet, vështirë se mund te mbarojnë kollaj.

DEMI: Nëse partneri ju kërkon me tepër kohe para se te hidhni hapa me rëndësi, pranojeni sepse nuk keni për te date te zhgënjyer. Beqaret do jene te fiksur pas dikujt dhe do bëjnë te pamundurën për ta bere për vete. Do arrijnë te fillojnë një lidhje te qëndrueshme. Financat nuk do jene te mirra për te gjithë. Matuni para se te kryeni shpenzime dhe do ndiheni mire.

BINJAKËT: Do bashkëpunoni fort me partnerin tuaj sot dhe do e shihni ndryshe te ardhmen. Mbrëmja do jete me emocionuese dhe plot ngjyra. Beqaret ka rrezik te jene viktime te dikujt qe do kërkohë thjeshte te tallt me ta. Mos u nixtoni te hidhni hapa. Financat do varen nga mënyra sesi ju do i menaxhoni. Po qëndruat me këmbë ne toke nuk do keni asnjë lloj problemi.

GAFORRJA: Dëgjojeni me kujdes këshillat qe do ju japë partneri juaj gjate kësaj dite sepse vetëm ne këtë mënyrë do mund te ruani një marrëdhënie te ngrohte. beqaret sado qe do lodhen se kërkuarin prinçin e tyre te kultirë nuk do mund ta gjejnë dot. Ne planin financiar fatmirësisht do jene te afirmet qe do ju mbështesin fort dhe nuk do ju lënë për asnjë cast te gaboni.

LUANI: Marrëdhënija juaj me partnerin do jete shume e ngrohte sot. Do dini si te ruani një komunikim te ngrohte dhe do toleroni me tepër nga me pare. Beqaret ka rrezik te zhgënjehen nga disa persona qe ne dukje ishin perfekte. Fatmirësisht qe nuk do kenë bere premtime. Financat nuk do jene te mira kështu qe shmangni çdo lloj investimi te tepruar.

VRGJËRËSHA: Priten momente te lumtura sot për te gjithë ju qe jeni ne një lidhje. Do ndiheni mjaft te kënaqur ne krahet e partnerit dhe nuk doni te ndaheni për asnjë cast. Beqaret ka rrezik te bien ne dashuri me personin e gabuar. Mund te lëndohen pa mase shume shpejt. Financat do vazhdojnë te jene te turbullta ne çdo moment. Nuk do arrihi as te kryeni shpenzimet me te nevojshme.

PESHORJA: Tregohuni me duruar me partnerin tuaj sot sepse ai nuk do jete ne humor dhe mund te beje gjëra te gabuara pa umenduar gjate. Beqaret do vazhdojnë te qëndrojnë vetëm edhe për disa kohe. Sot nuk do realizojnë dot takimet e ëndëruara. Financat do jene te mira dhe do arrihi te hiqni edhe disa para mënjani për ti shpenzur për qejf. Vazhdoni ti menaxhoni njësjaz te ardhurat.

AKREPI: Çëshjjet e zemrës nuk do ju ecin keq gjate kësaj dite, megjithatë ka edhe me mire. Shfrytëzoheni çdo moment kur te jeni pranë atij qe doni dhe shprehni si te mundni ndjenjat. Beqaret do bëjnë mire t'i pranojnë ftesat qe do ju bëhen sepse po i neglizhuar gjithmonë kane për te mbetur te vetmuar. Saktori i financave do jete i qete. Nuk do keni asnjë problem.

SHIGJETARI: Mos u tregoni kokëfortë sot ne jetën tuaj ne çift dhe pranoi here pas here te hapni rruga. Partneri nuk do jete ne humorin e duhur dhe mund te acarohet për gjithçka. Beqaret do kenë me shume fat se me pare dhe do e ndryshojnë statusin. Gjendja e financave do jete e trazuar për shkak te shpenzimeve te pallogaritura qe keni kryer se fundi.

BRICJAPI: Jeta juaj ne çift do përmirësohet mjaft gjate kësaj dite. Do jeni me te bute me partnerin tuaj dhe do kërkoni falje për disa gabime qe keni bere me pare. Beqaret do kthehen për asgjë. Nëse dikush nuk ua mbush mendjen plotësisht mbajeni luk. Me financat tregohuni sa me te arsyeshëm ne mënyrë qe gjendja te filloje te përmirësohet. Nuk merr t'ia ditni mbanë.

UJORI: Fati do jete ne anën tuaj gjate kësaj dite. Do shikoni neper vende te vesanta me partnerin dhe do përjeroni emocione e kënaqësi pa fund. Beqaret nuk duhet te nixton për asgjë. Nëse dikush nuk ua mbush mendjen plotësisht mbajeni luk. Me financat tregohuni sa me te arsyeshëm ne mënyrë qe gjendja te filloje te përmirësohet. Nuk merr t'ia ditni mbanë.

PESHQIT: Dita do filloje mire sot për ata qe janë ne një lidhje, por shume shpejt situata do ndryshoje tërësisht për shkak te disa personave te jashtëm qe do ndërhyjnë. Mos ju besoni atyre me shume sesa atij qe keni ne krah. Beqaret bëjnë mire t'i marrin gjerit si t'iu vijnë. Gjendja e parave do jete goxha mire, çka do ju japë mundësinë te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.

FJALËKRYQI KRIPTOGRAFUAR

10x10 cryptogram grid with letters and numbers.

FJALËKRYQI KRIPTOGRAFUAR

Completed cryptogram grid.



Abonohu!

[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...

**Për t'u abonuar
ju lutemi kontaktoni me:**



Posta Shqiptare

042 375 598 ; 04 237 55 98 ; 066 20 17 771
abonime@postashqiptare.al



Agjencia e Abonimit të Shtypit

04 422 11 08 ; 066 20 47 825
arben.trenova@yahoo.com



Adrion ltd

04 22 40 018
069 40 36 824
sales@adrionltd.com



**MUND TË LEXONI
GAZETËN NË:**



në kompjuter
në adresën: www.shqiptarja.com

iphone

ipad

[SHQIPTARJA.com]

në versionin dixhital

SHKARKON FALAS APP

tek website:
www.SHQIPTARJA.com
nga Apple Store



Duke blerë abonimin
ju mund të lexoni gazetën
që nga ora 2:00 e mëngjesit
dhe paguani më pak